

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7699 E diel 4 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Intervista

në "News 24"

Nga ADI KRASTA

Shqipëria, një vend me politikë anormale



Opinion

Ditës

Nga DEUTSCHE WELLE

Angela Merkeli hapi rrugën për epokën pas saj

Dorëheqja e dy ministrave të Brendshëm është një tregues doktrinar i sjelljes së njerëzve ndaj kriminalizimit të vendit, kanabizimit. Jam i ...  
Vijon në faqen 21

Dinjtet, përgjegjësi, kulturë e punës, më e mira për vendin. Këto fjalë të mbeten në mendje nga deklarata e bujshme e Kancelares Merkel, për ...  
Vijon në faqen 21



"Ngjarja te Biloku zgjati 60 sekonda"

## "Ku je, afrohu me armë", prokuroria zbardh bisedat e Ervis Martinajt

Ekspertët izraelitë zbulojnë komunikimet në "WhatsApp" dhe "Telegram" të të plagosurit

Prokuroria e Tiranës ka siguruar prova të reja për vrasjen në Bilok të ndodhur më 4 tetor. Gazetarja Klodiana Lala raportoi për "BalkanWeb" se bëhet fjalë për prova që rëndojnë pozitën e Ervis Martinajt, aktualisht në burg. Prokuroria ka zbuluar biseda në aplikacionet "Whatsapp" dhe "Telegram" të Martinajt me miqtë e tij pak minuta ...  
Në faqet 2-3

### EDI RAMA, MESAZH PS-SE: ASNJE KOMENT PER VENDIMIN, POLITIKA ESHTË SHAH

# META NUK DEKRETON SANDER LLESHIN MINISTER: S'ME BIND

Zbulohet arsyeja, ministri i emëruar nga Rama refuzoi takimin e thirrur nga kreu i shtetit. Dyshimi, mund të emërohet zv/ministër i Brendshëm



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dhe ministri i emëruar i Brendshëm, Sander Lleshi

LLOGARITE E 2015-2017

### LSI-PDIU kaluan djathtas, ja si ndryshon balanca e votave në zgjedhje

Në faqen 4

FORMULA E ATP

### Pronarët, skema për të përfituar nga kompensimi i përshpejtuar

Në faqen 7

PERIPECITE NE DIKTATURE

### Zef Margjinaj, historia e një shqiptari patriot dhe antikomunist

Në faqen 11

3 VETE NE BURG

### Linja e Greqisë, si bëhej trafikimi i sirianëve nga kufiri deri në Shkodër

Në faqen 9



Studiuesi i njohur, Artan Shabani sqaron iniciativën me koleksionin e artistëve

## Si e shmangën soc-realizmin piktorët e njohur

Ekspozohen veprat e atyre që studiuuan jashtë, Abdurrahim Buza dhe Sadik Kaceli

BEN ANDONI

A ta ishin formuar jashtë. Dhe, jo vetëm ata, por edhe një grup i madh artistësh të disiplinave të tjera të artit. Ajo që i bashkonte ishte përballja e re me metodën që mbizotëronte në vendin e tyre: Realizmi Socialist. Një pjesë e



tyre nuk do ta përballonte lehtë dhe pasoja do të ishte dënimi shembullor; kurse të tjerët do të vepronin me formën dhe me gjetjet. Lasgush Poradeci do të vetë izolohej dhe do t'i drejtohej natyrës. Odhise Paskali do të ishte monumental, ashtu si edhe veprat e tij, duke ...  
Suplement

Në faqen 9

INTEGRIMI NE BE



### "Le Figaro": Mafia shqiptare ka pushtuar Francën, zbardhet aktiviteti

Në faqen 8

## VRASJA TE BLOKU DOSJA E PROKURORISE

Kërkohej masa "arrest me burg": Rrëzohet pretendimi që shkoi rastësisht në lokal

# "Ku je? Afrohu me armë", prokuroria zbërthen celularin e Ervis Martinajt

Hetimi gjen komunikimet në WhatsApp dhe Telegram

Prokuroria e Tiranës ka siguruar prova të reja për vrasjen në Bllok të ndodhur më 4 tetor: Gazetarja Klodiana Lala raportoi për "BalkanWeb" se bëhet fjalë për prova që rëndojnë pozitën e Ervis Martinajt, aktualisht në burg.

Prokuroria ka zbuluar biseda në aplikacionet "Whatsapp" dhe "Telegram" të Martinajt me miqtë e tij pak minuta para ngjarjes ku mbeti i vranë Fabian Gaxha. E pikërisht me viktimën, por edhe disa miq të tjerë duket se ka komunikuar 36-vjeçari Martinaj. Gazetarja Lala duke cituar burime nga prokuroria, raportoi se kur Martinaj është paraqitur në lokalin Monopol iu ka kërkuar miqve të afroshin dhe të paraqiten aty të pajisur me armë.

Pra, sipas prokurorisë nuk ka qenë takim i rastësishtë, siç ka thënë Martinaj në dëshminë e tij dhe shërrit nuk ka pasur si shkak ngacmimet e këngëtares Elvana Gjata, por konflikte të mëparshme. Kjo është një provë e re, por ekspertiza e telefonit mund të nxjerrë të tjera detaje.

"Por zhvillimi tjetër nga hetimet për vrasjen në Bllok të shokut të Vis Martinajt është fakti se prokuroria shqiptare ka kërkuar ndihmë juridike nga shteti i Izraelit. Telefoni i Martinajt është dërguar për t'u ekspertuar nga ekspertë izraelitë. Dy ditë më parë ka ardhur përgjigje nga Izraeli dhe ekspertët izraelitë kanë arritur të zbërthejnë telefonin. Ekspertiza e ardhur nga Izraeli do paraqitet në gjykatë. Prokuroria do këmbëngulë që Martinaj të mbetet në burg pasi sipas saj ka prova të forta", raportoi gazetarja Lala.

Aktualisht për ngjarjen janë të shpallur në kërkim disa persona. Bëhet fjalë për Ervin Matën, i dashuri i këngëtares Elvana Gjata, Fabio Alushi dhe truproja i këngëtares, Mevil Bilo.



Ervis Martinaj

### PALET E PERFISHIRA NE SHERR

#### ■ (Të plagosur, nën arrest)

Ervis Martinaj, 36 vjeç, banues në Tiranë  
Eljon Hate, 28 vjeç, banues në Shkodër

#### ■ (I vranë)

Fabian Gaxha, 28 vjeç

#### ■ (Në kërkim nga policia)

Ervin Mata, 31 vjeç, banues në Tiranë  
Fabio Allushi, 42 vjeç, banues në Tiranë  
Mevjol Bilo, 41 vjeç, banues në Tiranë

### DOSJA E PROKURORISE

"Gazeta Shqiptare" zbardh sot pjesë nga kërkesa e prokurorisë për masën e sigurisë së Ervis Martinajt. Prokurorët Anisa Qilimi, Kreshnik Ajazi dhe Artan Lulaj kanë zbuluar mesazhet në WhatsApp dhe Telegram të Martinajt me miqtë e tij.

"Nga akti i ekspertimit teknik-elektronik nr.11694, dt.02.11.2018 i aparatit telefonik të sekuestruar të ar-

restuarit Ervis Martinaj kanë rezultuar këto të dhëna me rëndësi për hetimin:

Në rrjetin Whatsapp më datë 04.10.2018 rezultojnë këto komunikime:

Ora 21.12 komunikon me numrin 0699470XXX regjistruar me emrin "Boli" me tekst "mer" dhe më pas ora 21.15 "afrohu në bllok përballë billioner te rrobat e shtrenjta".

Ora 21.16 komunikon me numrin 0682145XXX regjistruar me emrin "San" me



### DEKLARATA E POLICISE

Policia në vendngjarje gjeti 11 gëzhoja, arme zjarri tip Glock, 10 000 euro, aparate celulare dhe 3 automjete. Pak pas krimit policia gjeti edhe një motor në zonën e Kopshtit Botanik që dyshohet se ka lidhje me ngjarjen.


tekst "afrohu bllok", "mer ne gjë me vetr" dhe ora 21.45 "Ku je?".

Në regjistrin e kontakteve të aparatit telefonik me emrin Boli është regjistruar numri 0699470XXX, ndërsa me emrin San numri 0682145XXX.

Në rrjetin telegram më datë 04.10.2018 rezultojnë këto komunikime me kontaktin e regjistruar me emrin "Aldoo" që i përket numrit në regjistrin e kontakteve të aparatit telefonik 0699187XXX nga ora 21.04 deri në orën 21.19:

Ku je (shkruan E.Martinaj)  
afrohu  
Po pres Olsin me ik me taku (shkruan Aldoo)

Te local  
Ols  
Ols  
Mos bono  
Ca veni je  
Lidhu me cunst  
Afroh  
Me arm  
Ok  
Ndalo para lokalit arit  
Ok  
Erdhem  
Jam me Olsin  
Qunat po vin  
Po cunat



Vendi ku ndodhi ngjarja

### ARRATIA E AUTOREVE

Autorët e ngjarjes pas të shtënave kanë dalë me shpejtësi nga lokali. Në kamera duket që njëri prej tyre është larguar në këmbë në rrugicat e Bllokut, tjetri me makinë, ndërsa i treti nuk duket në pamjet e kamerave të sigurisë.

Afroji  
Po sapo dalin nga shpija  
Ti ku je  
Un per 1 sekond aty  
Cunav te dyqani redit  
rrobave afroh  
A erdhe  
Po te lokali arit jam  
Ku

Po ashtu, rezulton në komunikim 18.58 e në vijim me kontaktin e regjistruar Aldoo ku bëhet fjalë komunikimi "marum me kret... të dyja...po ju dhashë për 3 cop...pse...edhe për 1 g...G kujt...ati me porch...".

I nderuar zoti gjyqtar. Nga të dhënat e sipërcituara rezulton se: Nga momentin që personi nën hetim Ervis Martinaj, i shoqëruar nga Eljon Hato dhe një person i paidentifikuar hyn në ambientet e dyqanit "Monopol" dhe deri në momentin që në të njëjtin ambient futet vik-

tima Fabjan Gaxha dhe personi tjetër i paidentifikuar kalon një periudhë kohore prej rreth 70 sekonda.

Rezultojnë konfliktet brenda ambienteve të dyqanit ndodh shumë shpejt pasi këtij momenti dhe se e gjitha ngjarja, duke përfshirë konfliktin fizik dhe më pas atë me armë, ndodh brenda një harku kohor rreth 60 sekonda, duke marrë në konsideratë faktin e daljes nga ambientet e lokalit të personave të përfshirë në ngjarje.

Rezultojn nga ekspertimi teknik-elektronik i aparatit

telefonik të personit nën hetim Ervis Martinaj se në orën 21.17 ka marrë një komunikim elektronik në aplikacionin "Whatsapp" nga kontakti i regjistruar me emrin "Boli" me tekst "tek dyqani me veshje të shtrenjta përballë Billionerit", pra rezultojn që shkruarja e të hetuarit Ervis Martinaj në dyqanin ku ka ndodhur ngjarja nuk ka qenë rastësore, siç ai deklaroi, por ai ka rakoruar për këtë takim me të hetuarin tjetër Ervin Mata. Rezultojn dyshimi se viktima Fabjan Gaxha dhe personi tjetër i paidentifikuar kanë qenë së bashku me të hetuarit Ervis Martinaj, Eljon Hato dhe personin tjetër të paidentifikuar përpara ngjarjes duke shkruar në afërsi të saj me automjetin tip BMW X5.

Të gjitha këto rrethana të rezultuara nga hetimet janë të tilla që rrëzojnë pretendimet e të hetuarit Ervis Martinaj se ai ka shkruar rastësisht në dyqan ku është takuar me Ervin Matën dhe se konflikti i ndodhur mes viktimës Gaxha dhe të hetuarit Bilo ka qenë rastësor dhe i shkëputur prej tij. Po ashtu rezultojn dyshimi se i hetuari Martinaj ka njoftuar përpara se të shkojë në vendin e ngjarjes personat shoqëruar të tij madje ka shkruarut të shkojnë me armë, shkruhet në dosjen e prokurorisë.



DOSJA/ Në orën 21:28 futet viktimja Fabian Gaxha, në 21:29 del komandoja Mevjol Bilo

# Kamerat në Bllok, sherri dhe vrasja ndodhën për 60 sekonda

*"Elvana Gjata do t'i merrte çelësin Ervin Matës, ndaloi një 'G Class' dhe këngëtarën e ngacmuan"*

Vrasja e Fabian Gaxhës dhe plagosja e të tjerëve në sherr ka zgjatur rreth 1 minutë. Prokuroria ka zbardhur dinamikën e përplasjes në zonën e Bllokut në 4 tetor dhe ka zbardhur kamerat e sigurisë së bizneseve në zonë. Sipas prokurorëve, rezultoi se "e gjitha ngjarja, duke përfshirë konfliktin fizik dhe më pas atë me armë, ndodh brenda një harku kohor rreth 60 sekonda, duke marrë në konsideratë faktin e daljes nga ambientet e lokalit të personave të përfshirë në ngjarje".

"Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjithë kronologjinë e ngjarjes, minutë pas minute, sipas dosjes së prokurorisë.

### KRONOLOGJIA

Është bërë këqyrja e pamjeve filmike të subjekteve dyqan "Monopol" dhe "KFC", ku nga krahasimi edhe me aktet e tjera procedurale, ka rezultuar se :

Më datë 04.10.2018 ora 18:54, shtetasit Ervin Mata, Geldo Hoti (Liçaj), Fabio Alushi, Mevjol Bilo kanë hyrë brenda në ambientet e dyqan "Monopol". Në këto momente ka hyrë edhe një shtetas e identifikuar dhe pyetur nga ana jonë, shtetasja E. L., e cila deklaroi se ka qenë me qëllim të shikonte disa artikuj që pronari Redi Popescu tregëtonte dhe largohet rreth orës 21:21:07.

Rreth orës 20:37, nga dyqan "Monopol", ka dal shtetas Ervin Mata, i cili është duke folur në telefon dhe sipas deklaratimit të shtetasit Redi Popescu, Ervini del jashtë për t'u takuar me të fejuarën e tij shtetasen Elvana Gjata, për të shkëmbyer një çelës shtëpie. Ajo e kishte parkuar automjetin e saj në rresht për dy. Në momentin që Ervini ka qenë duke bashkëbiseduar me të fejuarën, në rresht të tretë, ka kaluar një automjet dhe personi/personat që kanë qenë brenda tij kanë ngacmuar të fejuarën e Ervinit. Ky automjet ka vazhduar qarkullimin drejt "KFC" dhe për një moment ndalon dhe kryen manovrën e ecjes mbrapa dhe pasi qëndron aty afrohet shtetas Ervin Mata, pamje të cilat janë regjistruar nga DVR e subjektit "KFC".



Elvana Gjata



Ervin Mata

Rreth 10 sekonda më pas, te vendi ku automjeti kish të ndaluar dhe bisedonte me Ervin Matën, afrohet edhe shtetas Mevjol Bilo dhe bisedojnë me personin/personat që ndodhen brenda në automjet, ku vërehet se Ervini e shtyn me dorë shtetasin Mevjol Bilo me qëllimin për ta larguar. Po sipas deklaratimit të Redi Popescu-t, ku shprehet se ka dëgjuar nga Ervini se personi që ishte në drejtim të automjetit ishte ish shoku i ngushtë i tij, dhe kjo duket edhe nga pamjet filmike ku Ervini largon Mevjol-in me qëllimin për t'u sqaruar vet, megjithëse Mevjoli nuk largohet, por i qëndron aty pranë. Pasi shkëmbejnë disa fjalë, rreth 1 minutë më pas Ervini me Mevjolin, largohen në drejtim të dyqan "Monopol", ndërsa automjeti vazhdon në drejtim të "Sky Tower".

Automjeti në dukje është i markës "Mercedes Benz", tipi "G-Class", ngjyra e zezë me disqe të zeza, por pa targë të identifikueshme.

Duke këqyru pamjet filmike të "Monopol", vërehet se Ervin Mata nuk futet brenda në dyqan, por vetëm Mevjoli, i cili pasi futet del përsëri, dhe në pjesën e derës së daljes, në dukje ka një armë zjarri pistoletë, të cilën e fut në brez nga krahu i djathtë i tij me dorën e majtë. Gjithashtu, në rend kronologjik, pas tij dalin Geldo, Fabio, një person i paidentifikuar, dhe në fund një person i identifikuar në rrugë operative si shtetas Ard B. Duke kaluar përsëri te pamjet filmike të "KFC", vërehet se Ervini kalon përpara këtij subjekti dhe pas tij vijnë me radhë Mevjoli, Fabio, Geldo, Redi dhe i fundit,

i distancuar nga këta, shtetas Ard B. dhe të gjithë ecin në trotuar në drejtim të "Sky Tower" dhe pas një vonese rreth 1 minutë më pas, në pamje shfaqet Ervini, i cili po kthehet duke ecur në trotuar dhe pas tij janë Mevjoli, Redi, Fabio, Geldo dhe në fund Ard B.

Duke kaluar te pamjet e "Monopol", vërehet se të gjithë personat e përmendur më sipër hyjnë përsëri brenda dyqanit. Rreth 14 (Katëmbëdhjetë) minuta më vonë, kur ka shënuar ora 20:58, brenda në dyqan ka hyrë shtetas Ajaks B.

Rreth orës 21:26:58, në dyqan hyjnë shtetas Ervis

tetasi Ajaks B.

Rreth orës 21:29:36, nga dera e dyqanit dalin në rrjedhë kronologjike shtetas Mevjol Bilo, Ervin Mata, Geldo Hoti dhe Fabio Alushi.

Rreth orës 21:29:48, nga dera e dyqanit ka dalur Redi Popescu dhe pas tij ka qenë Ervis Martinaj.

Rreth orës 21:30:27, nga dera e dyqanit ka dal personi i paidentifikuar që hynë disa sekonda përpara viktimës Fabian Gaxha.

Rreth orës 21:30:30, në dyqan hynë përsëri Redi Popescu, ku duhet theksuar se dera në hyrjen e dyqanit është e hapur dhe i shtrirë për tokë duke rënkuar është i plagosuri rënd Eljon Hato.

Rreth orës 21:31:10, Redi Popescu ka dal përsëri nga dyqani.

Rreth orës 21:34:41, i plagosuri rënd Eljon Hato, duke u zvarritur ka arritur të kalojë derën e dyqanit dhe aty vjen e merr një person, i cili është ende i paidentifikuar. Ky person bën transportimin e Eljonit duke e mbajtur në krahë dhe kalojnë në trotuar të "KFC", dhe më pas i humbin objektivit të kamerës së "KFC".

### NGJARJA

Duke këqyru pamjet filmike të "Monopol", vërehet se Ervin Mata nuk futet brenda në dyqan, por vetëm Mevjoli, i cili pasi futet del përsëri, dhe në pjesën e derës së daljes, në dukje ka një armë zjarri pistoletë, të cilën e fut në brez nga krahu i djathtë i tij me dorën e majtë.

Martinaj, i shoqëruar nga shtetas Eljon Hato dhe një person ende i paidentifikuar. Rreth orës 21:28:08 në dyqan futet një person ende i paidentifikuar dhe direkt pas tij, vjen viktimja Fabian Gaxha.

Rreth orës 21:28:36, nga dyqani duket që del shtetas Ard B. i cili largohet duke dal nga shkallët e dyqan Monopol.

Rreth orës 21:29:16, nga dyqani largohet me vrap personi i paidentifikuar që shoqëron shtetasin Ervis Martinaj.

Rreth orës 21:29:19, nga dyqani largohet me vrap sh-

Në lidhje me këqyrjen e pamjeve filmike si më sipër, iu janë dërguar në rrugë shpresore të gjitha komisariteve të policisë të garkut të Tiranë, fotot e personave që kanë qenë pjesëmarrës në këtë ngjarje me qëllim kapjen e persona në kërkim dhe identifikimin e personave të tjerë. Po ashtu, janë kryer sekuestrimet e pamjeve filmike të kamerave të sigurisë së Kuvendit të RSH dhe Bankës Credins (ndodhur në rrugën Ibrahim Rugova). Këqyrja e këtyre pamjeve filmike është në proces nga policia gjyqësore.

### SEKUESTRO ARMES SE KOMANDOS

Në zbatim të urdhërit të prokurorit, është sekuestruar arma e shërbimit e shtetasit Mevjol Bilo, konkretisht arma tip pistoletë PX4, Storm, me nr. 3551B, e kompanisë "Beretta", me 12 (dymbëdhjetë) fishekë) në Repartin e Forcave Speciale 1050 në Zall Herr Tiranë.



### Dëshmia e pronarit të lokalit

## Redi Popescu: Mata tha 'e kam shok' për atë që ngacmoi Elvanën

Pronari i lokalit ku ndodhi ngjarja në Bllok, Redi Popescu ka dëshmuar për prokurorët dinamikën e ngjarjes. Sipas Popescut, këngëtarja Elvana Gjata u ngacmua në sy të Ervin Matës, por vetë Mata i kishte thënë grupit të vet që personi që kish bërë ngacmimin ishte "shok i ngushtë i tij" dhe prandaj për momentin sherri jashtë lokalit ishte evituar.

### DESHMIA E POPESCUT

I është marrë deklaratim përsëri shtetasit Redi Popescu, ku ndër të tjera ka deklarues se ditën e ngjarjes, rreth orës 20:40, përpara dyqanit të tij në Ish Bllok, ka ardhur shtetasja Elvana Gjata me automjetin e saj dhe aty në rrugë, duke qëndruar në parkim për dy, ka takuar shtetasin Ervin Mata dhe kanë shkëmbyer një çelës shtëpie. Në këtë moment, në rresht për tre ka kaluar një automjet tjetër, dhe personat që kanë qenë brenda në automjet kanë ngacmuar Elvana Gjatën, duke qenë Ervini prezent kanë debatuar me fjalë me të dhe në këtë çast nga dyqani i Redit kanë dal Joli (Mevjol Bilo), me djemtë e tjerë për t'u sqaruar. Sipas deklaratës, ai nuk i ka fiksuar karakteristikat e makinës që kishte ngacmuar Elvana Gjatën, por edhe detajet e mësipërme i kishte dëgjuar nga Ervini, ku ky i fundit u tregonte personave që ishin të shoqëruar me të. Po ashtu kishte dëgjuar nga Ervini se personi, i cili drejtonte automjetin me personat që kishin ngacmuar Elvanën, kishte qenë shok i ngushtë i Ervin Matës.

# PROJEKSIONI ZGJEDHJET VENDORE

Analiza e votave të 2015, me LSI dhe PDIU opozita më e fortë se mazhoranca

## Vendoret 2019, si ndikon në vota kalimi i LSI dhe PDIU në opozitë

Socialistët ruajnë fitoren vetëm në Korçë dhe Vlorë

Kalimi i Lëvizjes Socialiste për Integrim, por edhe së fundmi i Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet, në koalicionin e djathtë ka sjellë një ndryshim të ndjeshëm të raporteve të votave, çka pritet të shoqërohet me një betejë të fortë në zgjedhjet e ardhshme lokale, që me shumë mundësi do të mbahen në qershor të 2019. Me afrimin e këtyre dy forcave, opozita ka shansin e madh që jo vetëm të rimarrë bashkitë që fitoi në zgjedhjet e shkuara, por edhe të rivalizojë mazhorancën e majtë edhe në shumicën e bashkive që ajo drejton aktualisht, përfshi këtu edhe në disa bastione të saj. Natyrisht që në rastin e zgjedhjeve vendore ndikojnë shumë faktorë, ndër të cilët një rol shumë të madh kanë vetë kandidatët për kryetar bashkie dhe fushata që ata do të bëjnë, por gjithsesi domethënëse mbetet edhe vota që kanë vetë subjektet politike dhe koalicionet që ato do të krijojnë. Kështu, ndërsa kandidatët janë ende në fazë testimi nga të dyja kampet politike, natyrisht ajo që mund të na japë një projektion të përafërt për zgjedhjet e ardhshme janë rezultatet e zgjedhjeve të shkuara vendore, ku dhe karakteristikat janë të ngjashme. Për këtë kemi marrë në analizë votën që kanë marrë kandidatët për kryetar bashkie dhe votat që kanë marrë vetë partitë politike në garën për këshillat bashkiakë për 11 bashkitë e mëdha qendër qarku. Në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të 2015, nga 11 prej tyre opozita me konfigurimin e ri të koalicioneve arrin të sigurojë avantazh në 9 bashki, ndërsa e majta arrin të ruajë dominancën e saj në vetëm 2 prej tyre. Natyrisht që ky rezultat merr të mirëqenë faktin se LSI dhe PDIU do t'i tërheqin votat e tyre në bllok në koalicionin opozitar ku tashmë janë pjesë.

### REZULTATET

Kalimi i LSI-së dhe PDIU-së në koalicionin e djathtë në bazë të rezultateve të zgjedhjeve vendore të 2015-s jep efekt direkt edhe në bashkinë më të madhe në vend,

VOTAT PËR KËSHILLIN BASHKIAK	
<p><b>■ BASHKIA TIRANË</b> PS 124000 vota PD 89000 vota LSI 54000 vota PDIU 12000 vota (PD+LSI+PDIU 155000 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA VLORË</b> PS27829 vota PD14214 vota LSI 5431 vota PDIU 2293 vota (PD+LSI+PDIU 21936 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA SHKODËR</b> PS 17393 vota PD 34416 vota LSI 11790 vota PDIU 280 vota (PD+LSI+PDIU 155000 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA DURRËS</b> PS 38765 vota PD31152 vota LSI 13170 vota PDIU 4313 vota (PD+LSI+PDIU 57907 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA ELBASAN</b> PS 29030 vota PD 22350 vota LSI 13170 vota PDIU 5800 vota (PD+LSI+PDIU 41320 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA FIER</b> PS 31062 vota PD18760 vota LSI 13733 vota PDIU 2648 vota (PD+LSI+PDIU 35141 vota)</p>	<p><b>■ BASHKIA GJIROKASTËR</b> PS 8928 vota PD 6841 vota LSI4234 vota PDIU 484 vota (PD+LSI+PDIU 11559 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA KORÇË</b> PS 21524 vota PD 19401 vota LSI 6840 vota PDIU 62 vota (PD+LSI+PDIU 19401 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA KUKËS</b> PS 10442 vota PD9888 vota LSI 1272 vota PDIU 1390 vota (PD+LSI+PDIU 12550 vota)</p> <p><b>■ BASHKIA LEZHË</b> PS 15259 vota PD16602 vota LSI 3175 vota PDIU 1347 vota (PD+LSI+PDIU 21124 vota)</p> <p><b>■ Koalicioni opozitar me votat zgjedhjeve lokale 2015</b> PD 507 mijë vota LSI 259 mijë vota PDIU 59 mijë vota Në total 825 mijë vota</p> <p><b>■ Koalicioni i mazhorancës</b> PS 673 mijë vota</p>

atë të Tiranës. Kryetari aktual i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj në zgjedhjet e shkuara ka marrë 160000 vota dhe nëse këtyre votave do t'u heqim votat që arritën të marrin LSI-ja dhe PDIU-ja në garën për këshillin bashkiak, atëherë rezultati do të ndryshonte. Më konkretisht LSI-ja ka marrë në zgjedhjet e shkuara në Tiranë 54 mijë vota, ndërsa PDIU-ja 12 mijë, pra të dyja së bashku kanë 66 mijë vota. Dhe nëse 160 mijë votave që ka marrë Veliaj si kandidat i heqim 66 mijë votat që kanë marrë këto dy forca, atëherë

diferenca mbetet vetëm 94 mijë vota. Jo vetëm kaq, por, nga ana tjetër, nëse votat që kanë marrë këto dy forca ia kalojmë goftë kandidatit të atëhershëm të opozitës ashtu edhe vetë votës për këshillin bashkiak që mori opozita atëherë, peshorja do të ndryshonte kah. Një situatë e ngjashme paraqitet edhe në Durrës ku votat e LSI-së dhe PDIU-së ndryshojnë raportin e votave si për kandidat ashtu edhe për këshillin bashkiak. Kryetari aktual i Bashkisë së Durrësit ka marrë 56 mijë vota dhe nëse këtyre do i heqim rreth 26

### TIRANA

Kryetari aktual i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj në zgjedhjet e shkuara ka marrë 160000 vota dhe nëse këtyre votave do t'u heqim votat që arritën të marrin LSI-ja dhe PDIU-ja në garën për këshillin bashkiak, atëherë rezultati do të ndryshonte.

mijë vota që ka marrë LSI-ja dhe PDIU-ja, atëherë ai do të mbetet vetëm me 30 mijë vota, pra më pak se rivalja e tij në ato zgjedhje. Ndikimi në rezultat bëhet edhe më i madh nëse votat e LSI-së dhe PDIU-së ia shtojmë votave politike që ka marrë opozita në këshillin bashkiak ku raportin ndryshon ndjeshëm. PS do të humbiste edhe Bashkinë e Elbasanit, nëse marrim të mirëqenë llogarinë e ftohtë të votave të zgjedhjeve të shkuara. Kështu, kryetari aktual Qazim Sejdiu do të humbiste nëse votave që ai ka marrë si kandidat do t'u heqim votat që kanë marrë LSI-ja dhe PDIU-ja si subjekte në garën për këshill. Ai ka marrë 44 mijë vota dhe nëse do të hiqim prej tyre 19 mijë votat që ka marrë LSI-ja dhe PDIU-ja për këshill, atëherë, Sejdiu do të mbetet me vetëm 25 mijë vota, pra më pak se sa mori rivali i tij në ato zgjedhje. Edhe në rastin e Elbasanit raporti në votën për këshillin do të ndryshonte thellësisht në favor të opozitës. Rezultati do të ndryshonte në favor të opozitës edhe në Bashkinë Berat, Gjirokastrë dhe Fier. Gjithashtu, me këtë konfigurim të ri të koalicioneve, opozita e bashkuar do të siguronte sërish fitoren në bashkitë që drejton edhe aktualisht si Lezhë, Kukës dhe Shkodër, ku do të thellonte edhe më tej avantazhin e vet.

### SOCIALISTËT

Në bazë të këtyre llogarive socialistët do të ruanin fitoren e tyre vetëm në dy



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

## Votat e 2017, PS mbetet shumicë edhe pas largimit të LSI dhe PDIU

Ndryshe nga zgjedhjet vendore të 2015, rezultati i zgjedhjeve parlamentare të 2017-s i jep mundësi socialistëve të jenë shumicë në vota pavarësisht largimit nga koalicioni i tyre i Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Mbi bazën e shifrave zyrtare të KQZ-së rezultoni se pavarësisht se PDIU-ja dhe LSI-ja kanë kaluar në kampin opozitar, PS-ja e vetme është para me vota. PS-ja ka marrë në zgjedhje 764.750 vota në këto zgjedhje ku nuk pati koalicion dhe ku të gjitha partitë politike garuan si subjekte më vote. PD-ja rezultoi me vetëm 456.413 vota, ndërsa dy partitë tashmë në koalicionin e djathtë rezultuan, LSI-ja me 225.901 vota dhe PDIU-ja me 76.069 vota. Ndaj nëse mbledhim votat e PD-së, LSI-së dhe PDIU-së tashmë në një koalicion, në total ato kanë 758.383 vota. Pra, rreth 6 mijë vota më shumë se sa ka Partia Socialiste e vetme. Pra, nëse këto rezultate do të kishin vlerë për të llogaritur fituesin e zgjedhjeve lokale të ardhshme, atëherë në bazë të zgjedhjeve parlamentare të 2017-s, PS-ja do të arrinte të fitonte e vetme përballë gjithë koalicionit opozitar. Partitë po ndezin motorët për betejën e ardhshme elektorale, natyrisht votat e paraqitura ndryshojnë edhe për shkak të natyrës së votimit, pasi ndryshe janë zgjedhjet për kreun e bashkisë nga ato të përgjithshme, sa i përket peshës elektorale. Ndërsa duhet marrë në konsideratë edhe fakti i konsumimit të pushtetit në rang lokal e qendror, duke llogaritur edhe faktin nëse do të rikandidojnë sërish kryebashkiakët aktualë ose jo, si në Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnjë, të cilët kanë një apo më shumë mandate.

### VOTAT E ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE TË 2017

- PD 456.413 vota
- LSI 225.901 vota
- PDIU 76.069 vota
- Koalicioni opozitar në total 758.383 vota
- Partia Socialiste 764.750 vota

nga 11 bashkitë e mëdha dhe më konkretisht në Korçë dhe Vlorë. Kjo të paktën në garën për Këshillin Bashkiak. Kështu në Korçë pavarësisht kalimit të LSI-së dhe PDIU-së në koalicionin opozitar, të djathtë do të ishin sërish në minorancë në garën për këshill, ndërsa kemi një garë të fortë në atë për kan-

didat për kryetar bashkie. E njëjta panoramë na shfaqet edhe në Vlorë, ku të majtët arrijnë të ruajnë shumicën sërish pavarësisht kalimit të LSI-së dhe PDIU-së në kampin e djathtë. Nderkohë që ky kalim nuk do të ndikonte në garën për kryetar bashkie, ku Dritan Leli arrin të ruajë avantazhin.

Zbulohet arsyeja, Sandër Lleshi refuzoi takimin e para dy ditëve në presidencë

# Meta refuzon propozimin e Ramës, nuk dekreton Lleshin

"Meta nuk ka krijuar bindjen e plotë për t'i dhënë besimin"



Në limitet kohore që i lejon Kushtetuta, Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka refuzuar të dekretojë propozimin e kryeministrit Edi Rama për të emëruar si ministër të Brendshëm gjeneral, Sandër Lleshi. Nëpërmjet një njoftimi të shkurtër zyra e shtypit e Presidentit të Republikës bëri të ditur se ai nuk kishte krijuar bindjen e plotë për të dekretuar kandidaturën e Lleshit për postin e rëndësishëm të ministrit të Brendshëm, por pa dhënë më shumë shpjegime rreth arsyeve që e çuan në këtë vendim. "Presidenti i Republikës, Sh.T.Z Ilir Meta nuk ka krijuar bindjen e plotë për t'i dhënë besimin kandidaturës së z.Sandër Lleshi si ministër i Brendshëm", thuhet në njoftimin e Presidencës lidhur me këtë çështje.



**TAKIMI**  
Burime nga Presidencia bënë me dije dje në mbrëmje se kreu i shtetit ia komunikoi vetë Lleshit vendimin e tij për të mos e dekretuar. Sipas të njëjtave burime mësohet se Meta e priti në zyrën e tij Sandër Lleshin pasditën e djeshme, ku dhe e ka njohur me vendimin.

## Nishani ndryshe nga Meta: Kushtetuta s'më lejon ta kthej ministrin

Kreu i Shtetit refuzoi të firmosë dekretin e për emërimin e Sandër Lleshit si ministër i Brendshëm, duke u bërë kështu presidenti i parë që kthen një propozim të tillë. Askush nga presidentët e mëparshëm nuk kanë guxuar të kthejnë një propozim për emërim ministri, megjithëse janë shfaqur hapur kundër kandidatave të propozuara. Rasti më i fundit ka qenë ai i ish-Presidentit Bujar Nishani, i cili nuk ishte dakord me kandidaturat e sjella nga Rama për emërim ministrash. Bëhet fjalë për Arben Ahmetajn dhe Fatmir Xhafajn. Madje për emërimin e këtij ai foli edhe publikisht duke deklaruar se po të kishte mundësi nuk do ta dekretonte, por këtë gjë nuk ja lejonte Kushtetuta. "Në vlerësimin tim, kandidatura e ministrit të Brendshëm është e papërshtatshme. Por Kushtetuta nuk ia jep të drejtën Presidentit të Republikës për të refuzuar një kandidat për ministër, pasi i vetmi kusht i cili përcakton Kushtetuta për të qenë ministër, është ai i plotësisht të kryerëve për të qenë deputet. Në rast se Kushtetuta e vendit do t'ia njihte të drejtën Presidentit të Republikës për të refuzuar propozimet e kryeministrit, bazuar në arsyetime, unë do ta refuzoja kandidaturën e ministrit të Brendshëm", u shpreh atëherë Nishani.

## Xhafaj do vazhdojë të jetë ministër i Brendshëm

Fatmir Xhafaj do të vazhdojë të qëndrojë në detyrën e ministrit të Brendshëm edhe për disa ditë. Kjo pasi vendimi i Presidentit të Republikës për të mos e dekretuar pasardhësin e tij në këtë detyrë, e lë automatikisht Xhafajn në detyrë. Kushtetuta dhe ligji organik e detyron çdo të emëruar apo të zgjedhur që të qëndrojë në detyrë deri në momentin e ardhjes së zëvendësuesit e tij. Ndaj, pavarësisht se ai ka dhënë dorëheqjen prej më shumë se 8 ditësh, vazhdon të shkojë në punë në zyrën e tij thajse çdo ditë. Ai dha dorëheqjen të shtunën e një jave më parë, ndërsa lajmi u bë i ditur nga kryeministri Edi Rama. Xhafaj nuk ka dhënë arsye të qarta lidhur me këtë vendim të tijin, megjithëse në distancë ka pasur disa replika me kryeministri Rama.



## Rama SMS deputetëve: Do t'i dalim zot vendit dhe Kushtetutës

## Kryeministri u ka kërkuar deputetëve që të mos komentojnë

Mazhoranca nuk ka bërë gjatë mbrëmjes së djeshme asnjë koment lidhur me vendimin e Presidentit të Republikës për të mos dekretuar propozimin e Sandër Lleshit si ministër i Brendshëm. Pas vendimit të Presidentit Meta mësohet se kryeministri Rama ka kërkuar nga të gjithë që jenë të kujdesshëm dhe të mos bien prehe e këtij debati. Mësohet se ai u ka nisur një mesazh deputetëve të vet dhe ministrave të kabinetit që të mos bëjnë asnjë koment rreth kësaj çështje. Mes tjerash, Rama shkruan se shumica e ka për detyrë t'i dalë për zot kushtetutës dhe qytetarëve, ndërsa politikën e cilëson si një lojë shahu, e cila nuk duhet harruar sipas Ramës. "Lutem asnjë lloj



koment askush për vendimin e Presidentit! Ne jemi shumica dhe ne kemi detyrën t'i dalim zot njerëzve, vendit, Kushtetutës me maturi dhe vendosmëri. Politika është shah, mos e harro ni", thuhet në mesazhin e kryeministrit drejtuar deputetëve. Nëpërmjet këtij mesazhi kryeministri lë të kuptohet se presidenti me

vendimin e tij ka shkelur Kushtetutën dhe se mazhorancës i del për detyrë të mbrojë atë. Gjithsesi për shkak se është precedenti i parë i refuzimit të një ministri, nuk dihet ende se cila është mënyra që ka zgjedhur presidenti për të shpallur refuzimin e dekretimit të Lleshit. Por pavarësisht kësaj, kryeministri Edi Rama i duhet tashmë që të bëjë një propozim të ri dhe sa më parë, pasi nuk mund ta lërë qeverinë pa një prej anëtarëve të saj më të rëndësishëm. Natyrisht që emërimi i ministrit të ri të Brendshëm bëhet edhe më imediat për vetë faktin se bëhet fjalë për një nga dikasteret më të rëndësishme dhe të ndjeshme, siç është rendi publik.

### KUSHTETUTA

Askush më parë nuk ka pasur guxim që të refuzojë një propozim të kësaj natyre, pavarësisht se ka pasur qëndrime publike kundër emrave të propozuar. Kjo edhe për shkak se Kushtetuta nuk shpreh qartë në lidhje me dekretet e emërimeve të ministrave. Neni 98 i Kushtetutës përcakton se: "Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve", pa i dhënë të drejtë Presidentit ta refuzojë atë siç përcakton Kushtetuta në rastin e dekretave të ligjeve. Gjithsesi

Neni 103 i Kushtetutës përcakton se: "Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet" dhe se "Ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse", çka në fakt i jep të drejtë Presidentit që të bëjë verifikimin e plotësisht të kryerëve formale ligjore të emërimit të ministrit. Një pjesë e juristëve e kanë interpretuar këtë nen të Kushtetutës, duke i dhënë të drejtë presidentit që të mos e dekretojë një emërim ministri nëse ai nuk plotëson kriteret formale që do t'i du-

heshin edhe një deputeti për t'u zgjedhur. Natyrisht që një vendim i tillë do të fusë në një raport tjetër edhe më delikat marrëdhëniet mes presidentit dhe mazhorancës qeverisëse. Kjo pasi deri më tani ky është refuzimi i dytë që presidenti i bën një propozim direkt të kryeministrit, Edi Rama. Kujtojmë që prej më shumë se një viti ai mban në sirtar një tjetër propozim të rëndësishëm, atë për emërimin e kreut të SHISH-it. Meta nuk ka miratuar emërimin e drejtorit të ri të SHISH-it edhe pse në të njëjtën kohë as nuk e ka refuzuar atë.

## TAKIMI OPOZITA

Kreu i PD-së zhvilloi takime me fermerët dhe të rinjtë në Korçë dhe Devoll

# Basha nga Korça: Kush shet votën ka shitur të ardhmen

"Në Shqipëri, problemi numër një është braktisja e vendit"

Qarku i Korçës ka genë stacioni i radhës i turit të takimeve me qytetarë i kryetarit të opozitës, Lulzim Basha. Ai është takuar fillimisht me fermerët në Dvoran të Korçës, ku theksoi se vështirësia e fermerit sot është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e qeverisjes së keqe me të cilën Rama ka zgjedhur të drejtë vendin. Ndaj ai u bëri të qartë fermerëve se që të ketë një qeverisje të mirë dhe të drejtë duhet që askush të mos e shesë votën. "Kush shet votën s'duhet të flasë më as për mollën, as për çmim të lartë të pesticideve e as për çmim të lartë të naftës, sepse në atë moment ka shitur shpirtin. T'i ndërjegjësojmë njerëzit se kush shet votën ka shitur të ardhmen e fëmijëve të vet", tha Basha në takimet me fermerët. Ai shtoi se nëse qytetarët do të zgjedhin të lirë dhe me bindje të plotë, atëherë do të vijë më pas edhe një qeverisje që mendon edhe për hallet e fermerëve. "Pastaj vijnë të gjithë politikat, vijnë mbështetja e politikave të bujqësisë dhe e subvencioneve, që edhe molla juaj të dalë të paktnë në tregun e Kosovës. Së dyti, të sjellim investime këtu, sepse të gjithë këto tonelata mollë, pse të ngarkohen në kamionë, por të hapet fabrika këtu. Por sa kohë kryeministri i Brendshëm e kanë mendjen si të shpëtojnë veten. Prandaj duhet të ndërmarim hapin kryesor, ta pastrojmë politikën nga krimi", tha Basha me fermerët korçarë.

Banorët e Dvoranit deklaruan para Bashës se po përballen me të njëjtin shtetësim si edhe fermerët e tjerë në të gjithë Shqipërinë. Ata theksuan se kanë 5 vjet që nuk kanë marrë asnjë subvencion nga shteti, ndërsa denoncuan mungesën e tregut të mollëve dhe produkteve të tjera të zonës. "Sivjet nuk ka ardhur një maune me targa të huaja. Më parë vinin shqiptarët e Kosovës, vinin maqedonasit. Tani as edhe një. Nuk e di arsyen se pse nuk vijnë. Thonë që referencat në doganë, që qeveritë e huaja",

### TË RINJTË

"Në këtë trevë shumë fisnike dhe punëtore, kultura e punës këtu është një vlerë, e cila duhet të rrezatohet në të gjithë vendin. Në Devoll si kudo në Shqipëri, problemi numër një është braktisja e vendit. I keni parë shifrat, janë të frikshme. Më shumë se gjysma e të rinjve janë të rinjtë dhe të rejtat"

tha një fermer: "Jemi gati t'i shesim nën kosto prodhimet tona",-tha një prej tyre. "Pa eksport nuk mund të zgjidhet kjo situatë. Sepse edhe fuqia këtu ka rënë, njerëzit po largohen",-tha një tjetër fermer: Zona prodhon rreth 40 ton mollë në ditë, fermerët prodhojnë prej saj edhe nënproduktin e uthullës, por që sipas tyre i gjithë ky prodhim nuk shitet dhe nuk kompenson shpenzimet e tyre. Më pas kryetarit i Partisë Demokratike, Lulzim Basha u ndal edhe në një takim me

të rinjtë e Devollit, ku tha se të rinjtë shqiptarë po largohen për shkak të promovimit të antivlerave. Ai u ndal edhe tek të rinjtë, të cilët kanë mbaruar fakultetet dhe rendin sipas tij rrugëve, pasi nuk ka garë të ndershme për një vend pune, por hile dhe mashtrime.

"Në këtë trevë shumë fisnike dhe punëtore, kultura e punës këtu është një vlerë, e cila duhet të rrezatohet në të gjithë vendin. Në Devoll si kudo në Shqipëri, problemi numër një është braktisja e

vendit. I keni parë shifrat, janë të frikshme. Më shumë se gjysma e të rinjve janë të rinjtë dhe të rejtat. Këtu ka një paradoks të madh, sepse vendi për të cilët ka më shumë nevojë ky vend po largohet. Ajo që na ndan nga ajo që na sundojnë nuk është thjesht ideologjia. Shikoni se çfarë modeli jep për të rinjtë. Të rinjtë që kanë mbaruar fakultetin, kanë një diplomë, janë të zhgënjyer dhe të dëshpëruar. Pushteti i rilindjes nuk ka vend për ta, sepse vendin e tyre e kanë zënë persona me diploma false dhe të lidhur me krimin. Ky është një model, i cili po promovon antivlerat. Këtu të ky model e gjejnë veten të gjitha ata, që bëjnë përpara përmes hileve, të gjithë ata që politikën e shohin për të vjedhur dhe pasuruar",-tha Basha.

### Vasili: Rama e ka futur vendin në trekëndëshin fatal të Bermudës

## "Kryeministri përvetësoi miliarda dhe bleu pushtet"

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së Petrit Vasili ka sulmuar kryeministrin Edi Rama, duke e akuzuar atë se ka kriminalizuar vendin. Përmes një statusi në 'Facebook' Vasili theksoi se Rama është futur brenda trekëndëshit fatal dhe vdekjeprurës të Bermudës me trafik droge dhe krim të organizuar. "Kryeministri me vetëdije dhe pa shpëtim është futur brenda trekëndëshit fatal dhe vdekjeprurës të Bermudës. Trekëndëshi i Bermudës: trafik i shfrenuar droge, krim i organizuar në një më qeverisjen dhe pastaj grimand i parave të pista është trekëndëshi i vdekjes. Duke orientuar qeverisjen vetëm mbi këtë trekëndësh kryeministri përvetësoi miliarda, bleu pushtet, bleu media dhe u ndje përkohësisht i fuqishëm. Por sa më thellë



hyri brenda trekëndëshit krijoi varësi kriminale dhe kalim të pushtetit të krimi, u detyrua t'i sigurojë mbrojtje krimi me instrumentet e pushtetit, duhet të vazhdojë pasurimin e tij me financat e shtetit duke u zhytur thellë e më thellë në humnerën vrastare pa kthim të trekëndëshit të Bermudës, ku siç dihet avionët anijet e gjithçka hyn brenda tij përipihet dhe asgjësohet nga ky

trekëndësh", shkroi Vasili. Më tej ai theksoi se është detyrë e opozitës dhe e çdo shqiptari për ta luftuar dhe goditur këtë situatë të krijuar nga një qeveri e papërgjegjshme. "Zhytja në këtë trekëndësh duhet goditur në mënyrë të shprehur në proces i tillë është shpëtim për vendin ose më mirë të themi atdheun, i cili zhëbëhet përditë për shkak të tij. Por këtu shfaqen avoketërit pa atdhe të kryeministrit. Avoketërit e trekëndëshit që i shërbejnë atij, komandojnë prej tij dhe paguhen po prej tij. Duket sikur i shërbejnë kryeministrit, por në fakt, i shërbejnë trekëndëshit pasi bëjnë pa u lodhur alibin e trafikut të drogës, mbështesin kriminelët dhe jetojnë me paratë e pista ku ata ngjyeyjnë gishtin dhe në funksion të saj gatuajnë gjellën mediatake"-nënvizoi Vasili



Kryetarit të opozitës, Lulzim Basha, dje në Korçë

### SHKURTE

## "Ta hedhim qelbësirën", zv/ministri bën autokritikë: S'duhet ta thosha

Pasi denoncoi për plagjiaturë ish-zëvendës ministrin e Arsimit, Ervin Demon, Taulant Muka ka folur në "Kjo Javë" në 'News 24' duke treguar se çfarë e shtyu të denonconte një rast të tillë. Ai tha se roli i tij si studiues është që të identifikojë problemet e shoqërisë shqiptare dhe denoncimin e shes si shërbimi ndaj universitetit dhe arsimit në Shqipëri. "Unë jam studiues dhe si i tillë kërkoj për të nxjerrë shumë problematika. Shqetësimi im është sistemi. Ne do të shohim të gjithë titujt akademikë që janë dhënë. Largimi i Demos është për t'u përhëndetur. Ishte një akt civilizimi. Nëse do të mbetimi tek një emër s'ka asnjë vlerë, por duhet të adresohen problemet dhe të zgjidhen ato", tha zëvendësministri i ri i Arsimit.

I pyetur për një reagim të tij të mëparshëm ku shprehej "Ta hedhim poshtë qelbësirën" duke iu referuar kryeministrit Edi Rama, Muka bëri autokritikë. "Unë kam genë opozitar ndaj çdo qeverie dhe e kam pranuar këtë post për dashurinë që kam arsimin dhe kryeministrit më ka mbështetur në këtë nisim që kam marrë. Dua të bëj autokritikë për veten time se nuk duhet të ishte një reagim i tillë për pozicionin që unë kam marrë si akademik. Bëj autokritikë për mënyrën se si jam shprehur, ndërsa për problematikën që kam denoncuar nuk bëj autokritikë. Patjetër që do t'i kërkoja falje kryeministrit edhe nëse nuk do të isha në këtë pozicion vetëm për mënyrën si jam shprehur",-shtoi Muka.

## Balla: Nuk ka një vend tjetër ku opozita mungon kur diskutohet buxheti

Kryetari i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla e ka konsideruar të papranueshme që opozita mungon në Kuvend në një kohë që në të po diskutohet buxheti i shtetit për vitin e ardhshëm. Nga Labinoti ku zhvilloi takimin e radhës së logaridhënies, Balla i bëri thirrje opozitës të vijë në Kuvend dhe të marrë pjesë në diskutimet për buxhetin. "Unë nuk gjej një vend tjetër në botë që opozita të mungojë në Kuvend për diskutimin e buxhetit. Nuk ka më të rëndësishme për një deputet se sa të jetë në parlament për të diskutuar buxhetin e shtetit, se kur do të bëhet kanali vaditës, se kur do të bëhet rruga. Sa i përket atyre historive të akuzave, filmimeve, telenovelave me babale, pa babale të jeni të sigurt që prokuroria dhe gjykata do t'i shkojnë deri në fund", tha kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla. Balla i shoqëruar nga kryetari i bashkisë Elbasan, i kërkoi banorëve të Labinotit të komunikojnë me deputetin e tyre më shumë për të gjitha çështjet që i shqetësojnë.



"Prania e kriminelëve shqipfolës është rritur që nga viti 2010"

# "Mafia shqiptare ka pushtuar Francën, pret anëtarësim në BE për të zhvilluar aktivitetin"

## Le Figaro: Grupet kriminale, të përqendruara në grabitje, drogë dhe trafik emigrantësh

FRANCË

Mafia shqiptare është kthyer në një shqetësim të madh për policinë dhe autoritetet franceze. Bazuar në një dokument, mediat e këtij vendi bëjnë me dije se mafia shqiptare ka rritur prezencën. "Le Figaro", ka publikuar dokumentin, sipas të cilit "bandat shqiptare nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia kanë rritur prezencën në Francë, duke u bërë një rrezik real". Dokumenti që thuhet se ka dalë nga Ministria franceze e Drejtësisë, thekson se "mafia shqiptare po shpreson në anëtarësimin sa më të shpejtë të Shqipërisë në BE për të zhvilluar aktivitetin kriminal në Francë". "Le Figaro", shkruan më tej se prania e kriminelëve shqipfolës është rritur që nga viti 2010. Po kështu thuhet se këto grupe përqendrojnë aktivitetin e tyre kriminal në tri drejtime: vjedhjet, drogat dhe trafiku i emigrantëve. "Rezultatet janë mbresëlënëse: në mes të nëntorit 2017 dhe tetorit 2018, 5 shqiptarë kanë kryer 98 vjedhje me thyerje në njëmbëdhjetë departamente, duke grabitur mallra me vlerë 423,000 euro", citohet në artikull. Më tej vijon artikulli se, "grupet kriminale shqiptare, kanë nxitur trafikimin e heroinës në zonën kufitare franko-zvicerane, duke e bërë kështu trafikimin e drogës një nga aktivitetet e tyre të forta. Në maj, një azilkërkues u dënu në Lyon për transformimin e strehim-it të tij në një laborator heroinë. Aplikanti pretendonte se kishte vepruar me kërkesën e një bashkatdhetari dhe donte të ndihmonte babanë e sëmurë në Shqipëri. Ndërkohë që nuk gjelet pas trafikimit i emigrantëve të paligjshëm nga Kosova apo Shqipëria, veçanërisht drejt Britanisë. Pasi mbërrijë në veri të Francës, trafikantët shqiptarë kërkojnë për një kalim nga 1.500 deri në 5.000 euro.



Les mafieux albanais de plus en plus implantés en France

**GRUPET KRIMINALE**

"Rezultatet janë mbresëlënëse: në mes të nëntorit 2017 dhe tetorit të 2018, 5 shqiptarë kanë kryer 98 vjedhje me thyerje në njëmbëdhjetë departamente, duke grabitur mallra me vlerë 423,000 euro", citohet në artikull. Më tej vijon artikulli se "grupet kriminale shqiptare, kanë nxitur trafikimin e heroinës në zonën kufitare franko-zvicerane, duke e bërë kështu trafikimin e drogës një nga aktivitetet e tyre të forta.

### Nëna e 35-vjeçarit: Djalin ma vranë padrejtësisht


#### Vrasja e ekstremistit Konstandin Kaçifas, zyrtarë të policisë greke takojnë për informacion Ardi Velin

**TIRANË** - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu ka pritur një delegacion të policisë greke pas ngjarjes së ndodhur në fshatin Bularat të Gjirokastrës ku mbeti i vranë pas sulmit mbi policinë, Konstandin Kaçifas. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit bënë me dije se gjatë takimit përfaqësuesit e dy policive shkëmbyen informacion mbi operacionin ku mbeti i vranë 35-vjeçari i minoritetit grek. Gjithashtu, gjatë takimit u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit mes dy policive në të ardhmen. Mësohet se Veliu ka njoftuar grekët me dinamikën e operacionit pas pretendimeve që janë ngritur në

**DEKLARATA E PAPANIMOULIS**

Në lidhje me ngjarjen e ndodhur një javë më parë ka reaguar dhe zv/presidenti i Parlamentit Europian dhe deputet i partisë së kryeministrit Aleksis Cipras, Dimitrios Papanimoulis. Ai u shpreh në një intervistë për mediat greke se minoritari që u vra në Gjirokastrë ishte ekstremist dhe jo hero. Sipas tij duhet të sqarohet nëse Kaçifas mund të neutralizohet pa u vranë, ndërsa deklaratat e kryeministri shqiptar Edi Rama i ka cilësuar të papërshtatshme.

vendin fqinj. Ndërkohë që janë ndalur nga policia e Gjirokastrës dy grekë veprime të dyshimta. Pasi janë marrë në pyetje nga policia, ata janë lenë të lirë. Ndërkaq, pohohet se ekipi grek do qëndrojë në Tiranë deri në mbyllje të hetimit. Diplomacia greke konsideron se kërkesa e familjes për dorëzimin e trupit duhet pranuar menjëherë, pasi nuk ndikon në asnjë drejtim drejtësinë vendore, theksojnë burime të sigurta në Greqi. Nga ana tjetër, pala shqiptare dhe ajo greke po bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacion për të shmangur incidentet në ceremoninë e varrimit të Kaçifas. Aktualisht trupi i 35-vjeçarit ndodhet në morgun e QSUT në Tiranë për



Bledar Qemalaj

Ekstradohet nga Holanda fieraku i dënuar me 32 vite burg për vrasje dhe trafik heroine

**FIER** - Një 39-vjeçar nga Fieri i dënuar me 32 vite burg për vrasje dhe trafik heroine është ekstraduar dje nga Holanda. Bëhet fjalë për Bledar Qemalajn, i cili u ekstradua ditën e djeshme nga specialistët e Interpol Tirana nga Amsterdami drejt vendit tonë. Mësohet se Qemalaj është arrestuar nga autoritetet policore holandeze me qëllim ekstradimit drejt Shqipërisë, në zbatim të urdhër-arrestit ndërkombëtar të nxjerrë nga Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë me vendim penal nr. 18 datë 28.03.2006 e ka dënuar këtë shtetas me 23 vjet burg për veprën penale "Vrasje me paramendim". Ngjarje kjo e ndodhur më datë 03.05.2004 në rrugën "Qemal Stafa", Tiranë, ku Bledar Qemalaj ka vrarë me armë zjarri shtetasin E.V. Po ashtu, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë me vendim penal nr.68, datë 20.11.2009 e ka dënuar këtë shtetas me 8 vjet burg për veprën penale "Trafikim të lëndëve narkotike". Kjo për faktin se në datën 25-26 gusht 2004, Bledar Qemalaj, në bashkëpunim me disa shtetas të tjerë ka arritur që të trafikojë nga Shqipëria drejt Italisë 15 kg lëndë narkotike e llojit (heroinë). Gjithashtu, Gjykata e Apelit Vlorë me vendim penal nr. 298 datë 22.10.04 ka lënë në fuqi vendimin penal nr. 103 datë 27.05.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila ka dënuar me 1 vit burg, për veprën penale "Mbajtja pa leje e municioneve luftarake".



Konstandin Kaçifas

ekspertizë të thelluar, ndërsa hetimet po zhvillohen nga prokuroria e Krimeve të Rënda. Nëna e ekstremistit grek, Konstandin Kaçifas ka folur sërish për mediat greke. Vasilia Kaçifas kërkon nga autoritetet shqiptare që t'i kthejnë trupin e djalit, që sipas saj u vra padrejtësisht. "Përse na bëjnë të vuajmë? Pse nuk na japin fëmijën shqiptarët? Fëmijën tim e vranë padrejtësisht. Unë jam duke pritur për fëmijën tim në shtëpi. Çfarë po bëjnë ata për kaq shumë ditë?", është shprehur ajo.

**Shoqëria përbarimorë JUSTITIA**

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza III, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:  
 T'ruajtë Ndërrësi me sip. totale prej 250 m<sup>2</sup>, nga ku truajtë 250 m<sup>2</sup>, dhe ndërrësi 101 m<sup>2</sup>, nr. pasurisë 9/ 383, Vol. 16 fq. 101, zona kadastrale 6532 me adresë L. "Sheq'i Madh" Fier, e regjistruar në emër të Envor Demir Buzi  
 Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.276.000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë  
 Ankandi zhvillohet në datën 30.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

**Shoqëria përbarimorë JUSTITIA**

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza dyte, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:  
 Apartamenti me nr.pas.7/21-1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sip.138.40 m<sup>2</sup>, Tiranë në pronësi të Gentian Kujtim TOSKË  
 Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 81.379 (tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) EUR.  
 Ankandi zhvillohet në datën 04.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

**STUDIO PËRBARIMORË GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

Dl. 05.11.2018 ora 16:00  
 Përfundim Ankandi i Dytë për pasuritë:  
 - Pasuria "Lokali nr.4" me sip.66 m<sup>2</sup>, me adresë L.13, Plazh Durrës.  
 Me çmim 45 200 Euro  
 - Pasuria "Lokali nr.5" me sip.43 m<sup>2</sup>, me adresë L.13, Plazh Durrës  
 Me çmim 36 120 Euro  
 - Pasuria "Lokali nr.6" me sip.110 m<sup>2</sup>, me adresë L.13, Plazh Durrës  
 Me çmim 98 560 Euro  
 Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRBARIMORË GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Btv.kryesor (ish Kinma Iliria), Kati-2, Durrës, Kontakti Çaj 0682096575



Pronari i hotelit në Tiranë shpërthen në lot: S'dija gjë, policia më trajtoi si skllav

# Zbardhet skema, ja si bëhej trafikimi i sirianëve nga kufiri me Greqinë deri në Shkodër

## Gjykata lë në burg me afat 30 ditor 3 nga të arrestuarit, 2 të tjerë lirohen kundrejt garancisë pasurore

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër veni dje masën e sigurisë "Arrest me burg" me afat 30 ditor për shtetasit: Gjokë Murçaj, Ndue Ulaj dhe Griseld Dekovi, të akuzuar për "Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit" për 11 shtetas sirian nga Greqia në Malin e Zi. Nga ana tjetër gjykata vendosi të lirojë me masën e sigurisë garanci pasurore shtetasit: Saimir Karaj dhe Florjan Tole, i pari me 500 mijë lekë të reja, i dyti me 300 mijë lekë të reja. Gjatë seancës shtetasit e dyshuar dhe avokatët mbrojtës mohuan akuzat duke thënë se s'kanë pasur dijeni për shtetasit sirian se ata kanë dashur të kalojnë në mënyrë të paligjshme kufirin. Prokuroria kërkoi lënie në qeli për 5 shtetasit që u arrestuan pak ditë më parë gjatë operacionit të koduar "GRE-HOT", por gjykata vendosi të lirojë dy prej tyre. Në kërkim mbetet shtetasi Pjetër Preka, i cili dyshohet se është kryesori i veprimtarisë për dhënie ndihmës për kalimin të paligjshëm të kufirit për emigrantët. Prokurorja e

**PËRGJIMET**  
Prokuroria dhe gjykata mbajnë sekret përgjimet e shtetasve që u arrestuan gjatë operacionit të koduar "deri sa të përfundojnë hetimet paraprake, çka do të thotë se avokatët Anton Kosteri, Edit Gërçari, Bujar Hoti dhe Blerim Bazhdari nuk i kanë ende përgjimet. Nga 11 sirianët, 6 janë evidentuar gjatë transportimit dhe ndjekjes prej 48 orësh nga policia e Shkodrës dhe Forcat e Posaçme Operacionale të Tiranës ndërsa 5 të tjerë janë gjetur në hotelin "White House".

Kryebushat, në afërsi të Shkodrës shtetasi Griseld Dekovi ka marrë në mjetin e tij 3 sirianët që kishte Pjetër Preka dhe i ka dërguar deri në Vukpalaj në afërsi të kufirit me Malin e Zi, vend ky që i ka çuar edhe Ndue Ulaj. Aty policia i ka arrestuar këta dy shtetas bashkë me pjesën tjetër të grupit që u arrestuan në vende të tjera.

### DËSHMIA E TË AKUZUARVE

Pronari i hotelit "White House" tha se s'ka asnjë lidhje me këtë ngjarje dhe se ai thjeshtë ka pranuar në hotel sirianët pa e ditur nëse ishin ilegal apo se cili ishte plani i tyre, ndërsa shtoi se nuk i njeh personat e tjerë të arrestuar. "Kjo është një tentativë për të më shkatërruar biznesin. Unë kam punuar 15 vite në Greqi punë të ndershme. Shtëpinë e kam kthyer në hotel dhe kam 9 dhoma, ndërsa babai dhe vëllai jetojnë me qira. Janë absurd akuzat ndaj meje, sepse s'kam asnjë lidhje. Policia më trajtoi si skllav duke më marrë telefonin dhe fillimisht duke mos më pyetur fare, por më bënë të firmos pa e parë se çfarë shkruhej. Unë kam kryer juridikun dhe e di si funksionon. Kam gruan shtatzënë dhe kam fëmijën tjetër 18 muajsh. A janë në vete këta, çfarë bëjnë kësh-tu", duke dërdhur edhe lot dhe duke u dridhur teksa fliste. Edhe shtetasit e tjerë e mohuan se kanë lidhje me veprimtari kriminale apo se kishin për qëllim dhënie ndihmës për emigrantët.



Operacioni "GRE-HOT" në Shkodër

**OPERACIONI I KODUAR "GRE-HOT"**

- PERSONAT E ARRESTUAR
- 1. Ndue Ulaj, 33 vjeç, banues në fshatin Vrakë, Malësi e Madhe
- 2. Saimir Karaj, 34 vjeç, banues në Tiranë
- 3. Florind Tole, 26 vjeç, banues në Tiranë
- 4. Griseld Dekovi, 24 vjeç, banues në lagjen Dobraq, Shkodër
- 5. Gjokë Murçaj, 33 vjeç, banues në lagjen Partizani, Shkodër
- NË KËRKIM
- Shtetasi me inicialet Pjetër Preka

Gjokë Murçaj tha se ka qenë në Elbasan tek një i njohur dhe rastësisht i ka marrë duke i dërguar deri tek hoteli që ata i kanë kërkuar ndërsa pohoi se ka qenë i vetëm dhe jo me Pjetër Prekën siç pretendon prokuroria. Avokati Anton Kosteri tha se në akte është e shkruar se klienti i tij, Murçaj ka dalë i vetëm nga hoteli dhe jo i shoqëruar me kënd tjetër. Griseld Dekovi

u shpreh se një person që nuk e njeh shumë mirë e ka telefonuar dhe ka shkruar për të marrë shtetasit sirian në Kryebushat, por pa e ditur se çfarë janë ata, ndërsa shuma që do merrte nga këta pasagjerë ishte 30 euro. Edhe Ndue Ulaj mohoi akuzën duke thënë se ka transportuar thjeshtë pasagjerë dhe asgjë më shumë. Në fund prokuroria kërkoi "Arrest

me burg" për të gjithë, por dy prej tyre, pronari i hotelit, Saimir Karaj dhe punonjësi që kishte nisur punë një ditë përpara se të regjistrohej procedimi penal, Florjan Tole u liruan me garanci pasurore, ndërsa për tre të tjerët gjykata dha masën e sigurisë "Arrest me burg" me afat 30 ditor. Prokuroria dhe gjykata mbajnë sekret përgjimet e këtyre shtetasve deri sa të përfundojnë hetimet paraprake, çka do të thotë se avokatët Anton Kosteri, Edit Gërçari, Bujar Hoti dhe Blerim Bazhdari nuk i kanë ende përgjimet. Nga 11 sirianët, 6 janë evidentuar gjatë transportimit dhe ndjekjes prej 48 orësh nga policia e Shkodrës dhe Forcat e Posaçme Operacionale të Tiranës ndërsa 5 të tjerë janë gjetur në hotelin "White House".



Ishte në kërkim ndërkombëtar, kapet 47-vjeçari italian me dy emra

**TIRANË** - Një 47-vjeçar italian është arrestuar dje nga policia e Tiranës, me qëllim ekstradimi drejt Italisë. Burime zyrtare nga policia pohuan se Pasquale Scalise ishte dënuar me 11 vjet e 6 muaj burg. Ky shtetas është person i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata Italiane e ka dënuar atë për veprat penale: "Mashttrim Financiar" dhe "Mashttrim kompjuterik". Mësohet se shtetasi italian, i cili kishte ndryshuar dhe emrin nga Pasquale në Andrea, qëndronte në Tiranë në zonën e "Ali Demit". Veprimet e mëtejshme do të kryhen nga Zyra e Interpolit Tiranë.

## Tentoi të vrasë bashkëshorten me armë zjarri, arrestohet agresori

**SHKODËR** - Policia e Shkodrës ka parandaluar përshkallëzimin e një konflikti brenda familjes, ndërsa ka vënë në pranga një bashkëshort dhunues. Bëhet fjalë për shtetasin Kolë Pisha nga Thethi, i cili u kap në flagrancë pas një telefonate të mbërritur në sallën operative të Komisarariatit të Shkodrës për një konflikt familjar. Sipas bluve, Pisha u arrestua, pasi ishte konfliktuar me bashkëshorten dhe e kishte kanosur atë për ta vrarë. Ndërkaq, mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi u gjet dhe u



Aema e sekuestruar nga policia

sekuestrua në cilësinë e provës materiale dy armë zjarri (pushkë) dhe municion luftarak. Gjithashtu, po në Theth, pas informacioneve të marra në rrugë operative se një shtetas po qarkullonte me armë zjarri.

Policia është vënë menjëherë në ndjekje të tij. Shtetasi D.Z. 22 vjeç, sapo ka parë që ndiqej nga policia ka hedhur armën kallashnikov dhe duke shfrytëzuar terrenin e thyer dhe errësirën ka mundur të largohet, ndërsa është shpallur në kërkim dhe vijon puna për kapjen e tij. Arma e zjarrit është sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për veprime të mëtejshme.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



# PATRIOTI I MADH PORTRET

Historia e një njeriu të përndjekur nga diktatura, që ia kushtoi jetën përpjekjes për lirinë e Shqipërisë

## ZEF MARGJINAJ

# "Rrno për me tregue", amaneti i një shqiptari të mirë e patriot

Zoti asht i Madh. I kjosim falë atij të lu mit që ka krijuë vdekjen, se përndryshej njerzit do t'kishin me kenë gjithmonë skllav të tiranve. Edhe kta do t'desin një ditë e ti duhet të jetojsh vetëm sa me tregue. Kurrgjá në mos kjosht i zoti me bá, rrno vetëm për me tregue. A e kupton shka due me t'hanë?"

Këto fjalë që At Marin Sirdani i shqiptoi dhjetëra vite më parë, fratit françeskan At Zef Pllumit, e nxitën këtë të fundit që 'me shpirt ndër dhëmbë' t'i mbijetojë ferrit komunist me një qëllim: të rrrojë aq sa të rrëfejë krimet e diktaturës që e shndërroi Shqipërinë në një kamp përqendrimi.

Nuk ishin të paktë njerëzit në ato vite të errëta që njësoj si Zef Pllumi, arritën t'i mbijetojnë bishës së kuqe dhe të rrëfejën tmerret që përjetoi populli shqiptar në komunizëm. Njëri prej tyre, ishte patrioti i madh, Zef Margjinaj.

"Ai që e ka jetuar në vetën e parë historinë e trishtuar të popullit shqiptar nuk ka shkruar vetëm për t'iu bindur mesuesit të vet, por për të dëshmuar se çfarë padrejtësish i janë bërë e bëhen akoma sot bashkatdhetarëve të tij", shkruan Margjinaj në epilog të veprës së tij. Në këtë libër, ai përshkruan me detaje përpjekjet e tij dhe të shokëve të vet për një Shqipëri më të mirë, rrefën torturat dhe dhunën që shqiptari i thjeshtë hijte nën komunizëm dhe glorifikon përpjekjet për liri të pjesës së shëndoshë të popullit tonë.

### KUSH ESHTË ZEF MARGJINAJ

Zef Margjinaj lindi në Bozhicë-Selita të Mirditës më 19 mars 1921. Mbasi kreu tri vite të gjimnazit, më 1939, kur Shqipëria filloi të bëjë pjesë në Mbretërinë Italiane, hyri në Armen e Karabinierëve dhe vazhdoi shkollën e karabinierëve në Itali. Deri në 8 shtator 1943 shërbeu me detyra të veçanta, ndërmjet të cilave për një kohë të gjatë pranë Luogotenencës së



Zef Margjinaj



Përgjithshme në Tiranë. Antikomunist i lindur, duke mos dashur të bashko-

het me nazistët, doli vullnet në Ushtrinë e Mbrojtjes Nacionale Shqiptare me gradën rreshter, i inkudruar në Batalionin Autonom të Prizrenit dhe luftoi kundër komunistëve në frontin kosovaro-malazez. Më vonë me regjimentin e Pejës luftoi në frontin antikomunist jugosllav të Rozhajit. Mbas fitores së komunizmit në 1944, datë fatale për Shqipërinë, doli në mal, ku u bashkua me repartet e partizanëve nacionalistë antikomunistë dhe, veç për një mrekulli shpëtoi nga kthetrat e sigurimit. U zgjodh sekretar i Këshillit të Lartë të Komitetit Antikomunist Sh-

### RRUGA E NJË SHQIPTARI DREJT LIRISË

"Drama e një antikomunisti dhe atdheu i vet Shqipëria". Ky është titulli i librit të kujtimeve ku patrioti Zef Margjinaj përmbodhi të gjitha peripecitë e jetës së tij që nga lindja në Shqipëri e deri tek "jeta e dytë" që ai krijoi pranë familjes në Itali. Ky libër është një dëshmi e dorës së parë të krimeve të komunizmit në Shqipëri.

burgosi në burgun e Prizrenit.

Mbas një loje të dyfishtë, gjithnjë brenda parimeve antikomuniste, arriti të shpëtojë nga burgu i jugosllavëve. Më 1951 kalon në Greqi dhe futet në një mision sekret parashutistësh perëndimorë. Bashkëpunon me anglezët, por nuk arrin ta çojë në fund misionin. Në Angli merr statusin e refugjtit politik dhe punon në Londër. Aty njihet me një zonjushë italiane, Velia Onesti, e cila ndodhej në Londër për punë. Martohet më 23 qershor 1955. Më vonë vendoset në Tiglio di San Pietro al Natisone në Itali pranë familjes së gruas, ku, mbas peripecish të tjera arrin të shijojë ngrohtësinë e familjes.

Si atdhetar i flaktë dhe antikomunist i vendosur nuk pushon për asnjë çast së menduari për Shqipërinë. Me një punë vetëmohuese të pandërprerë denoncon bëmat e regjimit komunist me fakte të dokumentuara në të

gjitha organizmat ndërkombëtare, si OKB, Amnesty International, etj.

Themelon një organizatë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, Albanians for Human Rights dhe ndihmon të gjithë shqiptarët e arratisur nga Shqipëria mbas vitit 1962 duke i sistemuar me punë, banim e dokumente të rregullta. Luan një rol shumë të rëndësishëm në favor të çështjes së vëllezërve Popa pranë qeverisë italiane, për mosdorëzimin e tyre nga ana e ambasadës italiane autoriteteve shqiptare e deri në lejimin për të kaluar në Itali.

Organizata "Heroizmi Shqiptar" e formuar në Detroit të Amerikës prej shqiptarëve që kanë vuajtur nën regjimin komunist e ka zgjedhur sekretar. Njëkohësisht ishte edhe bashkëpunëtor i organizatës Caritas", anëtar i Amnesty International" dhe sekretar i përgjithshëm i "Albanians for Human Rights".

qiptar. Mbas rendimit të situatës së brendshme, si pasojë e ekzekutimit të deputetit komunist B. Biba, me një grup prej 53 partizanesh nacionalistë, kaloi kufirin për në Jugosllavi. Kominformi e

### PJESE NGA VEPRJA

## Një jetë mundimesh... por bëra detyrën njerëzore dhe kristiane

Nuk është kollaj të bëj konkluzionet e dy kapitujve të jetës sime: i pari (më i mundimshmi) "Odisea" e jetuar në tokën amtare, për të cilën kam luftuar me shpresën e një lirie, që populli ynë nuk e ka fituar akoma dhe i dyti, mundimet që jam detyruar të përballoj për të zënë vend në atdheun tim të dytë me lirinë e shumë dëshiruar.

Dikush, duke lexuar këto rreshta mund të thotë: "Ehu! Gjëra të vjetra që u ka ikur vakti, e për me tepër që i dimë prej kohësh. Nuk ishte nevoja që një refugjat shqiptar të na tregonte fakte, që tashmë nuk kanë më asnjë rëndësi".

Po. Këta mund edhe të kenë të drejtë, por ai që e ka jetuar në vetën e parë historinë e trishtuar të popullit shqiptar nuk ka shkruar vetëm për t'iu bindur mesuesit të vet, por për të dëshmuar se çfarë padrejtësish i janë bërë e bëhen akoma sot bashkatdhetarëve të tij.

Ai regjim që është në fuqi akoma sot, nuk njihet në botë, sepse është një vend i vogël, jashtë gjitha aleancave të mëdha, ku njerëzit vazhdojnë të jetojnë në... terror.

Kush di të kuptojë, le ta kuptojë!  
Kush mund të bëjë diçka, le ta bëjë menjëherë!  
Nesër dikush ndoshta do të duhet të përgjigjet për moskallëzim. Atëherë do të jetë shumë vonë.

Unë nga ana ime kam bërë gjithë çfarë ka qenë në mundësitë e mia, e me këtë nuk dua të mburrem, sepse e kam konsideruar thjesht si një detyrë njerëzore dhe kristiane. Për këtë e kam ndërgjegjen të qetë.

## Nderimet që ju bënë Zef Margjinajt nga dy presidentë



ndihmuar popullin e tij, që i lodhur e i uritur bënte hapat e para drejt një jete më të mirë. Për kontributin e tij në

këtë drejtim, Presidenti i parë i Shqipërisë Demokratike Sali Berisha e dekoroi me Urdhrin "Nëna Tereza" me këtë motivacion: Për merita të shquara në luftën kundër regjimit komunist në përkrahjen e lëvizjes demokratike në Shqipëri si edhe për kontributin e madh që ka dhënë në grumbullimin e dërgimin e ndihmave humanitare për popullin shqiptar.

Më 27 dhjetor 1981 presidenti i Republikës italiane e ka nderuar me titullin Kavaller i Urdhrit "Al merito della Repubblica Italiana".

Jeta e Zef Margjinajt mbaroi në mënyrë të papritur më 0.2.1992, në një aksident automobilistik në Gradisca (Friuli). Një jetë e kaluar në luftë kundër dhunës komuniste, në sakrificë për të ndihmuar ata që arrinin të shpëtonin nga ferri i kuq, nuk mund të kishte tjetër fund, veçse në përpjekjen e palodhur për të

BOTIMI

# APOSTOLOPOULOU:

## Një biografi e panjohur për Skënderbeun në greqisht

Fatmira Nikolli

**G**jergj Kastrioti Skënderbeu. Një biografi e panjohur në greqisht që daton në mes të shekullit të 18-të. Ishte studiuesja greke Machi Paizi Apostolopoulou që foli në Konferencën Albanologjike kushtuar heroit. Shënon që në fillim të fjalës së saj se edhe pse janë shkruar për të disa biografi, biografia e tij e parë në greqisht shfaqet vonë, pavarësisht faktit që ka pasur teori në lidhje me origjinën e tij greke dhe bëmave të Skënderbeut kundër ushtrisë osmane që natyrisht qenë një thirrje edhe për vetë grekët.

Apostolopoulou tha se biografia e tij më e hershme e shkruar në greqisht u botua në 1812 në Moskë. "Kjo nuk ishte një vepër origjinale, por një përkthim i një teksti nga jezuit RP Duponcet, Histoire de Scanderbeg, Roy d'Albanie, që u botua në Paris më 1709. Kjo vepër u përkthye në greqisht, por përkthyesi nuk zgjodhi ta shënonte emrin e tij", tha studiuesja, duke informuar kështu se nuk ka të dhëna mbi atë që e ka përkthyer. Vërejtje se studiuesi ndryshëm ia kanë atribuar këtë përkthim dy emrave: Ioannis Bailas ose Konstantinos Tzechanis. "Kam pasur rastin të zbuloj një biografi deri tani të panjohur të Skënderbeut në greqisht, në një dorëshkrim të mesit të shekullit të 18-të, mes dyzet teksteve të tjera mbi historisë osmane. Teksti është shkruar nga krijuesi dhe pronari i dorëshkrimeve, Nikolaos Karatzas i Konstandinopolitit, një studiues, bibliofil dhe shkruar dorëshkrimesh, që ka jetuar në vitet 1705-1787. Dorëshkrimi tani ruhet në Bibliotekën e Universitetit të Janinës, që i është dhuruar nga metropolit i Korytsa- Eulogios Kourilas. Teksti i biografisë është shkruar në 140 faqe dhe ka titullin "Mbi arrijet e denja dhe të lavdishme të Gjergjit të Krujës, në greqisht Kastriotis, të njohur si Skënderbeu, njeshër dhe sundimtar i Shqipërisë dhe Epirit".


Machi Paizi Apostolopoulou, tha se vlen të përmendet që teksti grek nuk është një përkthim fjalë për fjalë, por një adaptim krijues, me emra interesantë të rajonit, të dhënë në greqisht. Në fjalën e saj, ajo prezantoi tekstin e zbuluar, shpjegoi hipotezat



e saj për kohën kur u bë përkthimi dhe komentoi disa pjesë interesante të tekstit që na mundësojnë të afrohem me një

datë të saktë të përkthimit grek. Së fundi, ajo propozoi disa sugjerime lidhur me emrin e përkthyesit dhe rrethanat historike

*Studiuesja helene, Machi Paizi Apostolopoulou për një vepër të 1800-ës*



që mund të kenë çuar te përkthimi.

Gjatë konferencës së mbajtur në Tiranë, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, studiuesja greke Machi Paizi Apostolopoulou tha se as emri i autorit, as ai i përkthyesit, as data e shkrimit apo e përkthimit nuk përmenden në askund.

"Bazuar te krahasimi me biografitë e tjera të njohura deri atëherë, kam arritur në përfundimin se greku anonim që e përktheu veprën e Demetrius Franchet, "Komentari i çështjeve të Turqisë dhe të Gjergj Skënder-

beu, princ i Epirit. Me jetën e tij dhe me fitoret..." është publikuar së pari, në Venecia më 1540", thotë ajo. Shton se gjithsesi, të dhëna të tjera e kanë çuar në përfundimin se përkthyesi grek ka përdorur botimin e veprës së Giovanni Bonardo në vitin 1584, i cili përfshinte disa ndërhyrje në botimin original dhe me titullin variant: "Gli illustri e gloriosi gesti et vittoriose imprese fatte contra Turchi, dal Sign. D. Giorgio Castriotto" (Gjeste të shquara dhe të lavdishme dhe ndërmarrjet fitimtare të bëra kundër Turqve, nga Sign.D. Giorgio Castriotto).

**K**a nisur të premtën në Kinema Milenium Tirana International Film Festival një prej eventeve më të rëndësishme kinematografike që zhvillohet në Shqipëri. TIFF pas aplikimit u kualifikua si festivali nga Academy of Art and Sciences USA me të drejtën që fituesi i Best Short Live Action/Animation të renditet në listën nga ku do të dalin fituesit e Oscar për këto kategori. Ky vlerësim e rendit TIFF midis 94 festivaleve më prestigjioze të planetit si: Cannes, Berlin, Venice, Locarno, Sundance, Tribeca, etj. duke i dhënë kështu një shans të madh filmave të prodhuar në Shqipëri, Kosovë, rajon e jo vetëm, të konkurrojnë për këtë çmim të madh. Ky lajm tërhoqi vëmendjen e regjisorëve dhe producentëve gjë që solli një rritje të ndjeshme të aplikimeve këtë vit në një numër rekord prej 3700

filmash. Komiteti ndërkombëtar i seleksionit të aplikimeve ka sugjeruar 128 filma në competition në kategoritë:

Feature, EYE on TIFF (debut feature film competition), Short Live Action, Animation, Student dhe Video Art & Experimental, Documentary, Balkan dhe In Albanian competition. Kliko për Official Competition. Gjithashtu, TIFF ofron edhe këtë edicion një program të pasur special me 127 filma. Për t'u përmendur janë Special Screenings, premiera të siguruar nga distributorët tanë partnerë, që po qarkullojnë pikërisht tani në kinematë e Evropës e të botës si: "Don't Worry, He Won't Get Far on Foot" nga Gus Van Sant, "Suspiria" by Luca Guadagnino, "The House That Jack Built" nga Lars von Trier, FOCUS i TIFF këtë vit do të jetë përkujtimi i 150-vjetorit të ngjarjeve të vitit 1968, që ndryshuan botën, por jo ëndrën për një botë më të mirë e më të drejtë. Pran-

## NIS FESTIVALI I FILMIT, SONTE SHFAQET "DELEGACIONI"



daj dhe FOR ANOTHER DREAM, ky program me ligjërata dhe filma të asaj epoke, do të vinë për publikun e interesuar në KINO bar çdo mbrëmje nga ora 19:00 me një program të pasur të kuruar nga Federico Rossin, Arbër Zaimi dhe Edon Qesari. Në vazhdim të nisjes së vitit të shkuar TIFF do të ofrojë KIDS program ekskluziv për fëmijët çdo ditë në Teatrin e Kukullave nga ora 10:30, si një investim afatgjatë për të rritur e edukuar audiencat e ardhshme të kinemasë me filmin artistik nëpërmjet projekteve të fituara në Creative Europe për shpërndarjen dhe promovimin e filmave europianë. Në kuadër të TIFF, e diela në mbrëmje, shfaq filmin "Delegacioni" të Bujar Alimanit, fituesi i Grand Prix në Varshavë.

E DIEL

4 Nëntor

2018



## Arti i Realizmit Socialist

# Si e shmangën studentët “e huaj” Abdurrahim Buza dhe Sadik Kaceli

NGA BEN ANDONI

A ta ishin formuar jash të. Dhe, jo vetëm ata, por edhe një grup i madh artistësh të disa plinave të tjera të artit. Ajo që i bashkonte ishte përballja e re me metodën që mbizotëronte në vendin e tyre: Realizmi Socialist. Një pjesë e tyre nuk do ta përballonte lehtë dhe pasoja do të ishte dënimi shembullor, kurse të tjerët do të vepronin me formën dhe me gjetjet. Lasgush Poradeci do të vetë izolohej dhe do t'i drejtohej natyrës. Odhise Paskali do të ishte monumental, ashtu si edhe veprat e tij, duke e respektuar Realizmin Socialist, brenda kanoneve të tij por pa iu përshtatur klasicizmit të rëndë. Abdurrahim Buza do të arratisë në materien e tij të origjinës, duke përshtatur një formë gati naive, që megjithëse i meritonte ankesat e gardianëve të Artit Socialist, nuk mund të kundërshtohet prej askujt për impaktet e mëdha patriotike. Sadik Kaceli do t'i mbetet besnik shkollës së vet, ndërsa do të ruhej sa më shumë të mos zbriste në artin, që ishte i detyrueshëm. Më me fat do të ishte Ibrahim Kodra, që mbeti jashtë vendit, nga ku do të eksperimentonte për një art krejt ndryshe, që asokohe e rendiste në artistët më modernë të kohës. Fat të trishtë pati piktori Vangjush Tushi, i cili u lind në Korçë dhe ndërron jetë në Kampin e Punës në Ballsh pas gati dhjetë vitesh internim.

“Do t'i ndaja në dy grupe, grupi i pare, janë ata artistë, të cilët e pranuan metodën e Realizmit Socialist dhe punuan me pasion brenda kornizës së artit zyrtar: Rasti i Nexhmedin Zajmit dhe Foto Stamos, dy artistë të nderuar dhe të rëndësishëm bën fjalë për këtë. Por kemi dhe artistët e tjerë, që u përshtatën disi, por nuk u përmbushën me artin zyrtar të Realizmit Socialist, ndoshta nuk e pranuan në krijimin e tyre artistik. P.sh Sadik Kaceli nuk e pranoi dhe ai mbeti këmbëngulës formimit të tij në akademinë franceze. Vlen për t'u theksuar fakti, që mjeshtri Kaceli doli i treti në konkursin e pikturës për Akademinë e Arteve të Bukura Franceze, ndërsa mjeshtri Abdurrahim Buza me veprat e tij e tejkalon formimin akademik italian dhe pikturon në një frymë të veçantë, duke trajtuar botën malësore, të cilës ai i përkiste”, shprehet studiuesi i artit dhe koleksionisti Artan Shabani.



Foto Stamo, “Ciganja”

Redaktor: Ben Andoni, 360

**Në këtë numër: MILJENKO JERGOVIÇ PËR KADARENË, SJELLË NË SHQIP NGA XHELAL FEJZA; ARTAN SHABANI, MARJORIE AGOSIN SJELLË NË SHQIP NGA GAZMEND KAPLLANI, LLAMBI BLIDO PËR BESIM TULËN, KUJTIM DASHI, ETJ...**

A

INTERVISTA

INTERVISTOI BEN ANDONI

Ajo që i bashkon të gjithë, sido mos ata që vinë nga vendet latine është ajo që ata të gjithë do të përcjellin në shkollën shqiptare. Akademizmi italian ndihet fare dukshëm në veprat e artistëve, të cilët studiuuan në akademitë italiane dhe një studiues mund të shikojë lehtë ndikimet që ata patën prej saj, "si ndershmëria ndaj punës, ngrohtësia, sjellja e figurës njerëzore në mjedise të vërteta, ç'ka përbën veçantinë e punës së tyre. Binomi artistik natyra dhe njeriu, të marra në Shkollën e vizatimit në Tiranë, ishte në një linjë me akademitë italiane. Laboratori përgatitor ishte pothuajse i njëjtë, por mos harrojmë se qytetet italiane ishin skena arti", thekson studiuesi.

Por, nuk mbaron këtu. Pasi, në vitet '70 shfaqet një frymë liberale në artin shqiptar, e cila do të rezultojë fare jetëshkurtyrë. Ka elementë interesantë të impresionizmit, ekspresionizmit, formalizmit, fovizmit, por vetëm kaq, pasi nga këtu fillon goditja në fushën e kulturës dhe të arteve. Historia e bashkësisë së artistëve të shkolluar jashtë, lihet pak pas kuintave. Fillon troku i rëndë i Realizmit Socialist dhe i tharë të saj, shumë syresh edhe brenda kësaj kolonie.

**E mrekullueshme ideja juaj për të sjellë në një ekspozitë të përbashkët, autorët që kanë studiuar në Itali para Luftës së Madhe. A mendoni se shkolla shqiptare e vizatimit i detyrohet këtij brezi?**

"Do të thosha që i detyrohet patjetër. Në vitin 1931 fillon në Tiranë Kursi i vizatimit me piktorin italian Mario Ridola dhe Andrea Kushin. Ridola ishte drejtori i parë (kur kursa kthehet në shkollë të rregullt).

Mbas një kohe të shkurtër zëvendësohet nga Odise Paskali. Vlen për t'u saktësuar, se pedagogët e parë në Shkollën e vizatimit ishin Andrea Kushin, Abdurrahim Buza, Lasgush Poradeci, i cili jepte lenden histori arti, Hajro Xhunga që jepte lëndën e Gjeometrisë deskriptive ose siç e quajmë shkurtimisht, Perspektivën artistike dhe Mihal Zallari (Histori - Gjeografi).

Në vitin 1933 kemi zyrtarizimin e shkollës së parë, kushtuar Artit Pamor, me emërtimin "Shkolla e vizatimit". Ndërtesa, ku u ngrit Shkolla e vizatimit, ka qenë ndër më të bukurat e kohës, dmth gjatë harkut të viteve 30. Një shtëpi banimi e Prefektit të parë të Tiranës, Qamil Pepa. Aty studiuuan emra të rëndësishëm të Artit Shqiptar, të cilët fituan bursa të merituar në akademitë e Romës, Firencës, Parisit, Torinos etj. Vlen për t'u përmendur, që në Tiranë, gjatë vitit 1933, kemi ndërtimin e Kompleksit të Ministrive, hapjen e Bulevardit të Madh, zyrave të fashos, sot Universiteti i Tiranës, ngrihet ngrehina, ku sot kemi Institutin e Arteve, Muzeumin Arkeologjik, Kolonat dhe Stadiumin olimpiq "Qemal Stafa".

Godinat krijonin një figuracion të caktuar të arkitekturës tipike fashiste, "Shpata e liktorit". Ndihet një hov i frymës italiane në arkitekturë, në planet rregulluese të qyteteve kryesore të vendit, Tiranë, Elbasan, Rubik, Porto Eda (Saranda), Berat etj. Ideja për të bërë bashkë artistët shqipëtarë, të cilët studiuuan në Akademitë italiane, ishte një ndër projektet, që kam pasur për zemër.

Artistët Simon Rrota, Zef Kolombi, Vangjush Mio, Foto Stamo, Fadil Pullumbi, Ibrahim Kodra, Abdurrahim Buza, Guri Madhi, Hasan Reçi, Vangjush Tushi, etj., kanë dhënë

Veprat e ekspozuara të piktorëve të njohur shqiptarë, që studiuuan jashtë vendit, po qëndrojnë të ekspozuara në Rezidencën italiane. Ato janë në zotërim të familjarëve dhe të koleksionistëve të ndryshëm dhe kuratori Shabani ka mundur që falë bashkëpunimit me ta dhe Ambasadën Italiane, t'i ekspozojë në mjediset e kësaj të fundit. Është për t'u vlerësuar sesi është gjendur gatishmëria për ta mundur nxjerrjen e pronës artistike të personazheve të ndryshme për ekspozim... Në këtë intervistë, kuratori flet përtej kësaj ekspozite, duke na treguar tiparet e punës së artistëve të ndryshme...

## Fati dhe metamorfoza e dhimbshme e artistëve të studiuar jashtë

*Flet Artan Shabani, studiuesi i artit dhe koleksionisti i njohur. Në këtë intervistë ai sqaron iniciativën e tij me autoritetet italiane për të sjellë për publikun koleksionin e artistëve, që kanë studiuar jashtë përmes koleksioneve të ndryshme*

një kontribut të jashtëzakonshëm me veprat e tyre në zhvillimin e artit realist shqiptar, një pjesë e madhe e tyre kane qenë pjesë e krijimit të Liceut Artistik "Jordan Misja" (1946) dhe të Institutit të Lartë të Arteve (1961).

**Në kulturën dhe njohuritë tuaja, a mund të zbulohen autorë shqiptarë, që kanë mbetur në Itali dhe që janë ende të panjohur?**

"Në njohurinë time më del të ketë ndonjë artist të panjohur gjatë atyre viteve. Do të ishte befasi mbresëlënëse nëse zbulojmë ish student të viteve 30 / 40 të cilët nuk njihen ende. Do të thoja është e pamundur. Nuk ishin të shumtë dhe pothuajse të gjithë artisët u kthyen në Shqipëri".

**Si i mbijetuan kanoneve të Realizmit Socialist këta artistë?**

"Do t'i ndaja në dy grupe, grupi i parë, janë ata artistë, të cilët e pranuan metodën e Realizmit Socialist dhe punuan me pasion brenda kornizës së artit zyrtar. Rasti i Nexhmedin Zajmit dhe Foto Stamos, dy artistë të nderuar dhe të rëndësishëm bën fjalë për këtë. Por kemi dhe artistë e tjerë, që u përshatën disi, por nuk u përbushën me artin zyrtar të Realizmit Socialist, ndoshta nuk e pranuan në krijimin e tyre artistik. Psh Sadik Kaceli nuk e pranoi dhe ai mbeti këmbëngulës formim të tij në akademinë franceze. Vlen për t'u theksuar fakti, që mjeshtri Kaceli doli i treti në konkursin e pikturës për Akademinë e Arteve të Bukura Franceze, ndërsa mjeshtri Abdurrahim Buza me veprat e tij e tejkalon formimin akademik italian dhe pikturon në një frymë të veçantë, duke trajtuar botën malësore, të cilës ai i përkiste.

Pjesa më e madhe e artistëve jetuan si profesorë të nderuar dhe të respektuar. Ish-



Artan Shabani

in profesorët që krijuan bazat e Artit Pamor Shqiptar, bashkë me studentët, e ardhur më pas nga Shën Pietërburgu, Praga, Bukureshti etj. Dëshiroj të përmend edhe rastin fatkeq të piktorit Vangjush Tushi, i cili u lind në Korçë dhe ndërron jetë në Kampin e Punës në Ballsh dhe gati dhjetë vite internim".

**A ka pasur ndonjë gjë të veçantë, në njohuritë tuaja, laboratorit përgatitor i punës së këtyre artistëve?**

"Akademizmin italian ndihet dukshëm në veprat e artistëve, të cilët studiuuan në akademitë italiane, ç'ka i shoqëroi për një kohë të gjatë në karrierën e tyre artistike, si ndershmëria ndaj punës, ngrohtësia, sjellja e figurës njerëzore në mjedise të vërteta, ç'ka përbën veçantinë e punës së tyre.

Binomi artistik natyra dhe njeriu, të marra në Shkollën e vizatimit në Tiranë, ishte në një linjë me akademitë italiane. Laboratori përgatitor ishte pothuajse i njëjtë, por mos harrojmë se qytetet italiane ishin skena arti. Në çdo 30 metra gjen një vepër arti, skulptura dhe arkitekturë mahnitëse. Studentët tanë

nuk mundën të sillnin frymën e kohës, që shfaqej në një pjesë të ajkës artistike italiane, sepse shkollat apo akademitë ishin me programe akademike dhe brenda kanoneve të studimit akademik. Artistët u kthyen në Shqipëri dhe nuk i jetuan vitet e bumit ekonomik si vërsnikët e tyre viteve në Itali. Mbas Luftës së Dytë Botërore Italia fillon të marrë një përmasë tjetër në ekonominë e vendit dhe kjo pasqyrohet në të gjithë shoqërinë italiane si dhe në art".

**Juve shquheni për një qëmtim elegant të trashëgimisë pikturike shqiptare. A mund të flitet për një shkollë shqiptare të pikturës? Apo më saktë, a tentoi ndonjë jehërë piktura shqiptare të sillte ndonjë frymë të veçantë në historinë e artit racional?**

"Në pikturën shqiptare ka pasur ndikime të qarta nga shkolla të ndryshme, perëndimore dhe lindore. Ç'ka pasqyroshin në prurjet e arteve të ndryshme. Mund të ve në dukje ndikime të shkollave nga Italia, Rusia, Çekosllovakia, sot Rep Çeke, Polonia,



FOTO STAMO

SIMON RROTA

IBRAHIM KODRA

Rumania, Zagrebi etj., Kemi dallim stilësh të ndryshme, por të gjithë bashkohen dhe përqëndrohen e qendërohen në ide të orientuara nga arti zyrtar i Realizmit Socialist. Të gjithë bashkë u përpoqën të krijonin një pikturë me frymë kombëtare, por brenda tu telës shumë të fortë të Metodës së Realizmit Socialist, ç'ka nuk mund t'u jepte artistëve shprehje veprimi.

Në vitet '70 shfaqet një frymë liberale në artin shqiptar, por shumë jetëshkurtër: Vihen re disa shkuarje drejt impresionizmit, ekspresionizmit, formalizmit, fovizmit, por... deri këtu shkoi mendimi artistik shqiptar. Menjëherë mbas vitit 1973, ndonëse ana profesionale u shpreh më mire, por nuk gjejmë më vazhdimësinë të ndikimeve të artit bashkëkohor, madje aty fillon goditja në fushën e kulturës dhe të arteve.

Kemi denime të disa artistëve, të cilët përfunduan edhe në burg si Edison Gjergo, Maks Velo, Ali Oseku, Vangjush Tushi, të tjerë në punë korrektorje dhe disa mënjanim nga jeta e gjallë artistike, duke iu prurë e drejta e ekspozimit, si psh Edi Hila, Vilson Kilica, Danish Jukniu. Kishte edhe artistë që u vetëlarguan nga skena e ekspozimit, si Thanas Papa, Alush Shima, Dhimitër Theodhori, etj., apo edhe fëmijë të nomenklaturës, si Arben Theodhosi, i cili pësoi dënim në internim nga i ati".

**A ishte zhgënjim për artistët shqiptarë (ata që Ju kemi zgjedhur për ekspozitën tuaj), kthimi në vend?**

"Mendoj se kthimi në Shqipëri nuk ishte zhgënjim ose zgjidhje e sforcuar, përkundrazi! Ata u kthyen me dashuri për familjet e tyre, për qytetet ku kishin jetuar, për vendin e tyre. Ata e ndjenë kthimin në At dhe si një akt patriotik, ku dikush u rreshtua edhe me armë në dorë në luftën antifashiste dhe të tjerë, që u rreshtuan në ndërtimin e institucioneve të para të artit shqiptar. Kemi vetëm rastin e Ibrahim Kodres, që nuk kthehet, por qëndron në Milano. Më vonë shfaqet piktori Lin Delija, i cili pasi arratiset nga Shqipëria, jeton në Antrodoko deri në fundin e jetës së tij. Ndërsa artistë të tjerë u kthyen të gjithë në vendlindje".

**A mund të na thoni diçka se si arritët që të menaxhoni të drejtat e autorit me pinjollët e artistëve tuaj?**

"Personalisht nuk kërkoj në asnjë mënyrë të marrë dhe drejtë të drejtën e autorësisë për asnjë artist që ekspozohet në Rezidencën Italiane. Është tërësisht jashtë interesave të mia. Ngulmoj në vënie në dukje të arrijtjeve të artit dhe artistëve shqiptarë. Veprat janë në zotërim të familjarëve dhe të koleksionistëve të nderuar shqiptarë, të cilët kanë meritë të veçantë për ruajtjen e veprave dhe për gadishmërinë e bashkëpunimit me Ambasadën Italiane. U shpreh mirënjohjen më të thellë. Janë ata që zotërojnë ligërisht të drejtat e pronës mbi veprat e huazuara për ekspozim. Kjo është një çështje e mbyllur".

**Çfarë ideje keni në të ardhmen e afërt për ndonjë aktivitet të tillë të përmasave kulturore?**

"Ideat për të ardhmen janë të shumta. Puna ka filluar me kohë. Së afërmi do të jetë një ekspozitë e madhe me artistët shqiptarë, por vetëm artiste femra. Ku do përqëndrohem si se është trajtuar figura e femrës në Artin Shqiptar, nga Sofia Zengo te Zamira Xhafa, nga Kristina Koljaka, skulptorja e parë shqiptare te Suzana Kalo, nga Androniqi Antoniu te Ina Lajthia, nga Liljana Çefa te Fatbardha Shkupi, një plejadë e nderuar artistesh dhe kështu me radhë. Do të jetë një ekspozitë mbresëlënëse me vepra të veçanta. Do të organizojmë edhe një ekspozitë me "outsider" nga arti shqiptar, artistë të cilët janë tepër të veçantë dhe ende të pavlerësuar. Por nuk do ndalemi këtu. Në vazhdim do të kemi edhe 7/8 projekte, por më mirë le t'ia lemë kohës për t'i shijuar dhe për të dhënë mbresat e përfutura.

Rëndësi ka që gjërat të rrjedhin natyrshëm, Brenda shtratit artistik, në bashkëkohësi dhe të kryhen me të vërtetë. Arti kërkon punë, durim, pasion, gjakim artistik të madh. Kush punon e kupton seriozisht çfarë do të thotë të ndërtohet ekspozita dhe të përditesohet art. Jam i bindur se jemi në një çast artistik kur do të kemi shprehje të bukura dhe të arrira artistike. E besoj këtë gjë dhe punoj për të".

## A ARGUMENT

NGA LLAMBI BLIDO\*

Në vitin 1972 asistova në ceremoninë e mbrojtjes së diplomave të studentëve të Institutit të Lartë të Arteve Figurative. Më tërhoqën vëmendjen dy tablo, ajo e diplomatit Avenir Sadikaj dhe e Besim Tulës. Te Tula vihej re sadopak përpjekja për të folur me gjuhën e ngjyrave, sidoqë, me ato trishtueshmërisht pak njohuri që shkolla jonë e artit jepte në këtë drejtim. Që nga ajo kohë ecuria e këtyre dy artistëve më është dukur interesante.

Besim Tula u bë shpejt jo vetëm kolegjor por edhe miku im. Ai hyri në rrethin tonë shoqëror që e kryesonte kolegu dhe përkrahësi ynë i madh dibrani Burhan Cami. Burhani krijonte një klimë për të gjithë në të ngrohtë dhe inkurajuese, por përveç kësaj ishte ai që na furnizonte dhe me libra e revista arti perëndimore.

"Pionieri", revistë për fëmijë e Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë së Punës së Shqipërisë ku unë para punuar më parë, kishte tani si piktor Besim Tula. Kështu në u lidhëm vetiu edhe në fushën e botimeve, ilustrimeve.

Me emërimin tim pedagog i Liceut Artistik, u kujdesa që edhe mikut tim të ri t'i gjeja herë pas here disa orë mësimi si i jashtëm. Me këtë rast munda të vlerësoj Tulën edhe si mësues pikturë. Ai fitoi shpejt vlerësimin e këshillit pedagogjik për punën sistematike, për rregullin dhe disiplinën, metodën e mësimdhënies. Mbase pikërisht për këto aftësi kandidatura e tij u rrëzua me të drejtë në Akademinë tonë të Arteve në konkursin për të zënë një vend si pedagog i pikturës aty. Dialogu mes nesh pati një vazhdimësi normale edhe më tej në vitet '80-të - '90-të.

Duke e pasur përherë pranë, siç shpjegova më lart, i kam ndjekur me vëmendje të gjithë hapat e besim Tulës të ri në moshë si dhe në pjekurinë e tij profesionale. Ishte e qartë që në krye se orientimi intuitiv i këtij piktori të ri që gjuha moderniste e artit. Ai u dha me pasion pas literaturës më të avancuar të kohës që kishim mundësi të gjenim në ato kushte. Këtë e vija re në elemente të rinj shprehës që ai mundohet të zbatonte në kuadrot e tij. Punonte përditë sipas një orari të rregullt. Bënte përshtypje këmbëngulja dhe vullneti i tij për punë dhe kërkime sistematike drejt një gjuhe personale.

Në këto vite artistit realizoi disa nga punimet e tij më të mira si "Në kapanonin e aksionistëve në pushimin e vapës", "Çiklisti dhe vajza", "Natyrë e qetë me shalqi", "Dy gjitonet te porta e avllisë" (interpretim sipas Simon Rrotës) etj. Tek Tula është përherë i gjallë malli dhe përfytyrimi për Shkodrën e tij të viteve të fëmijërisë.

Në ato vite Tula me familjen e tij (bashkëshorten Valdete dhe dy vajzat e tyre) jetonin në një apartament të vogël një dhomë e një kuzhinë. Kur shkoja dhe e takoja në shtëpinë e tij, gjeja të zotin e shtëpisë në dhomën e gjumit të ulur buzë

*Ai është një shembull i veçantë edhe sot, thotë autori. Piktura e tij është realisht krijimtari e angazhuar. Korrupsioni, krimi ordiner dhe ai i organizuar, veset dhe shfaqje të panumrta të abuzimeve me lirinë e demokracinë janë sot objekt i "realizmit të tij kritik", sepse me gjuhën e tij piktorike moderniste Besim Tula e furnizon artin e tij me motive konkrete dhe jetësore nga realiteti i ditëve tona. Imagjinata dhe energjia e tij krijuese janë vënë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe konstante këtij këndvështrimi kritik, referuar tij*

# MODERNIZMI KRITIK I BESIM TULËS



Besim Tula

krevatit bashkëshortor, përpara pëlthurës së tij të re të kavaletit-një karrige e rëndomtë, si dhe një stol përmbi të cilin kishte hapur kasëten e tij. Pas shakave të para dhe kafes me nga një teke raki që Valdetja e mirë dhe durimadhe nxitonte të na e servite, Tula niste të nxirrte nga poshtë krevatit bashkëshortor pikturat e tij të reja për të m' i treguar, ndërsa nga sipër dollapit të rrobave ato në të cilat boja nuk që tharë mirë. Dhe niste një "diskutim krijues", që vazhonte më tej kur të dy merrnin dhe zbrisnin tatapatjet kodrës "Mihal Grameno" për të rruftur kafën e dytë tek kafeneja elegante e Hotel 'Arbanës', brigjeve të Lanës.

Ai është një shembull i veçantë edhe sot. Piktura e tij është realisht krijimtari e an-

gazhuar. Korrupsioni, krimi ordiner dhe ai i organizuar, veset dhe shfaqje të panumrta të abuzimeve me lirinë e demokracinë janë sot objekt i "realizmit të tij kritik", sepse me gjuhën e tij piktorike moderniste Besim Tula e furnizon artin e tij me motive konkrete dhe jetësore nga realiteti i ditëve tona. Imagjinata dhe energjia e tij krijuese janë vënë në mënyrë të ndërgjegjshme dhe konstante këtij këndvështrimi kritik. Është fjala për një meritë të padiskutueshme në qendrimin e përgjegjshëm të një artisti serioz i cili, mes të tjerash, nuk ka punuar kurrë thjesht për treg, ashtu siç shumë të tjerë rreth tij e bëjnë këtë gjë hapur dhe paproblem. Sidoqë në natyrën e tij nuk kemi të bëjmë me një idealist në përgjithësi, në raportin me artin e tij Besim Tula mbetet një idealist. Besim Tula i përdor mjetet e tij me zhdërvjelltësi duke i shoqëruar me mesazhe të drejtpërdrejta dhe ka mbetur një artist i paprekur nga pushteti i tregut, propaganda dhe autopropaganda, modest.

Dihet tashmë se sa problematike ka qenë dhe mbetet mungesa apo varfëria e kritikës sonë të artit. Është një profesion i vështirë prandaj llafazanëria pavlerë dhe propaganda e autopropaganda që mbushin në disa raste botimet tona të artit është bërë problematike. Kështu kur gjenden artistë të këtitillë si Besim Tula të cilët jo vetëm e njohin konkretisht procesin krijues artistik, por kanë edhe aftësi kritike e analitike, meriton të vlerësohet. Besim Tula dallohet në këtë fushë për lakonizmin, mungesën e retorikës boshe, për qartësinë dhe konkretësinë, kurajën tipare këto që burojnë nga tërësia e e formimit të tij.

\*Piktor dhe kritik arti  
19.09.2018



## T

## TREGIM

NGA KUJTIM DASHI

## Vijon nga numri i shkuar

**T**ë Guttenbergut? - shqiptuan emrin nënë e bir thuajse njëherësh dhe sekush sipas mënyrës së vet; kryqëzuan shikimet me njëri-tjetrin të cuditur, po dhe të lehtësuar më në fund, pasi djali u dorëzua, kur nuk e prisnin dhe tashmë e morën vesh se kush paskesh qenë ai që ia kish prishur qetësinë djalit të tyre dhe të tjerat ishin të sigurt se do t'i merrnin vesh më vonë e can-gaca.

I ati u ngrit gjoja të qëronte një mollë, po i biri e nuhati, se ai qe ngritur të hapte më mirë derën e kuzhinës, të bënte zakonet, për të dëgjuar gjithçka e ëma e shumëpushtetshme, që nga dhoma e gjumit bisedën në mes tyre, si vëzhguese në detyrë. Nuk kishte një shoqe të dytë për nga pathosi i saj, për të qenë e informuar, a si i pëlqente të thoshte, për të qenë në dijeni si zonjë shtëpie për gjithçka që ndodhte deri në imtësi, si të mbulonte të gjitha shërbimet...

- Gjerman është ky? Kështu më tingëllon mua... - tha gjyshja.

- Po, po të Guttenbergut, po jo atij që shpiku shtypshkronjën, është tjetër Guttenberg ky... Nuk munda ta linte që t'i humbiste rasti pa e thumbar gjyshen.

- E lëshove që e lëshove shashkën, po më thuaj se kush është dhe ç'punë ke ti me këtë Guttenberg a si quhet? Je ngatërruar gjë me ndonjërin prej këtyre ndërkombëtarëve që iu këshillojnë? - iu drejtua i ati me një ton të prerë e autoritar, duke e përbajtur veten e t'i thoshte "ke guxuar?", si për t'u rikthyer për një çast të vetëm te misioni e autoriteti i pacënuar prindëror, te ai i mëparshmi, i hershmi fare, kur i biri i bindej gati verbërisht në procesin e plastellimit për gjithçka sa nga frika, sa nga ndëshkimi a turpi, e sa nga ajo që i ati i kishte marrë në duar jetën e tij dhe po e drejtonte në sfidat e kohës, si çdo adoloshent tjetër, që rritet para syve të prindërve të vet, nën tutelën e rreptë të tyre.

Besimi gati i verbër i tij te i biri, që fatmirësisht po i rritej i mbarë, fjalët e mira që dëgjonte poshtë e lart, mbajtja tërë kohën nën kujdes e vëzhgim të rreptë, gjithsesi për ta ruajtur nga ndonjë implikim me të keqen e për ta formuar sipas modelit që kishte konturuar në mendje, mbarëvajtja në shkollë, njohja cangaca me rrethin e gjerë shoqëror e miqësor të vetin dhe disa përfitime jo të pakta që nxori prej tyre kohë pas kohe, në shkëmbim të nevojave e shërbimeve të tjera ekstra për ta, kur iu lindnin nevojat a iu duhesh atyre, dhanë dhe frutin e vet. Drejtëpërdrejt nga aula e universitetit, me njëmijë e një halle dhe, duke mos lënë gur pa lëvizur, pati shansin ta fuste direkt e në administratën publike në dikasterin N të majtëve të djathtë, apo si bënte gjoja se e ngatërronte e ëma, duke iu thënë të majtët e djathtë, që ishin në pushtet. Fillimisht, sa për të futur kokën brenda, me kontratë tremujore, siç ishte marifeti që u gjet dhe me një rrogë modeste, si një nxënës në ekonomi, si bënte shaka; pastaj në konkursin e pranimit, në sigurimin e pikëve maksimale dhe, në fund, emërimi, gjithnjë e në çdo fazë pas kuintave shokët e miqtë e tij. Po ama i biri, ndryshe nga bashkëmoshatarët, nuk provoi qoftë dhe një ditë të vetme të sillej vërdallë e të bënte *geometrin* apo të shpërndante CV poshtë e përjetë, si traktet, nëpër zyra personeli apo ndër të njohur,

Po vazhdojmë tregimin, që në shpjellimin e tij përcjell problematika të jetës shqiptare me humorin fin të autorit, që e administron shumë mirë lëndën e tij...



që e përcillnin me sugjerimin "Ma dërgo njëherë një CV, shohim e bëjmë; mos nguro, shëno gjithçka në të dhe, shiko këtu mos u trego leshko, modest, a më i kështenë se papa. Edhe në qoftë se ke shkuar te daja a te xhaja për qejf jashtë shtetit për dy-tre ditë, shënoje që jam specializuar". S'i kishte shkuar munda bosh, përkundrazi.

Mirëpo mirënjohja ndaj të atit për udhëheqësinë e tij largpamëse, me kalimin e kohës, kishte pësuar krisje dhe, nuk ishin të pakta rastet, kur meritën për këtë ngjitje të shpejtë në shkallët e karrierës, jashtë dyerve të shtëpisë, po dhe brenda tyre, kur binte fjala, zuri t'i la njëhte më shumë vetes, zotësisë së vet, kraheve të vet dhe, se babai kishte bërë thjesht detyrën, si një dispeçer a polic rrugor, që i kishte treguar rrugën, shko këtu e shko atje; kishte bërë detyrën, po sidoqoftë, s'ia mohon kush, e ka bërë mirë; misioni i babait ishte i hershëm tashmë, i përkiste të shkuarës, historisë...

Edhe kur i hyri punës, për të marrë masterin prej të vërteti, - atëherë ndër të parët, që e nuhati se duhej siguruar edhe ai *kar-ton*, po që e kishte edhe njëfarë munda, - jo këtë të sotnin, që është bërë si ushtarllëku, ose shërbimi i detyrueshëm ushtarak, u kujtua për shokët e miqtë e babait që ende ishin dikushi nëpër katedra e departamente të universitetit publik, apo shumë syresh

që zgjuar befas instikti i mbrojtjes për ta shpëtuar nga e keqja të birin.

- E di unë kush po e çikrratë këtë punë, e di mirë... - tha masterxhiku tërë mllef, i cili në vend që ta kthjellonte e mjeçulloi akoma më shumë me hakërimin që u tret në një mllef të njohur prej tyre. Nga dhoma e prindërve u dëgjua e kollitura e së ëmës. Ajo, sipas kodit familjar po jepte shenjë që të ngrinin zërin, për të dëgjuar më mirë, si ta kish-

istër në qeverinë federale dhe, së fundi, ishte Ministër Federal i Mbrojtjes, ndër politikanët konservatorë më të admiruar dhe shihet si një kandidat i mundshëm për kancelar të ardhshëm të Gjermanisë...

- Do i biesh shkurt a si është halli yt? Ç'lidhje ka kjo me ty po të them?

Nga dhoma e prindërve u dëgjuan dy kollitje të forta të njëpasnjëshme të së ëmës, por masterxhiku nuk e mori vesh se çfarë sinjali po dërgonte ajo, s'i binte ndërmend

# Pas Guttenbergut një filxhan çaj me kamomil

ishin kthyer në poste të rëndësishme pas rikthimit të *të majtëve të djathtë* në pushtet. Masterxhiku ishte i bindur si dhe i ati, se ato të gjithë ishin çue peshë dhe po e ndihmonin, po e mbështetnin e po ndërnynin lirshëm në *veprën* e të atit për modelimin e tij në këtë fazë, që ta përgatitnin e ta kishin, qoftë dhe për një ditë të vështirë për ta një të tarratit të tyre në atë dikaster, ku jo për të pikuar, por rridhnin fondet. Në fillim, dukej se profesorët e doktorët këtë po e bënin si njëfarë detyrimi që kishin për t'ia shlyer nderat, të cilat ua kishte bërë dikur i ati i masterxhikut, po në darkën që shruan te "Taivani", në ditën kur mori masterin, - gjyshja vazhdonte të thoshte, kur e *hoqi qafë*, - ata, njëri pas tjetrit ia thanë troç fare. Tani të kemi ty atje! Je a.i., domethënë përfaqësuesi ynë në dikasterin tënd! Mos u bëj merak, sekush ka të *vetët* atje dhe në dikasteret e institucione të tjera; mos shiko që s'ndihen fare... Kështu është ndërtuar ky shteti ynë, që dalëngadalë po bëhet njëqind vjeç!... Njëqind vjeç, ama, po puro shqiptar!...

Masterxhikun toni autoritor i të atit e mblodhi dhe e kthjelloi ca. Madje i erdhi ca keq se mos atij befas i kishte lindur ndonjë keqkuptim për emrin e padëgjuar ndonjëherë të të huajt, që quhej Guttenberg, se mos e ngatërronte a mos kishte ndonjë implikim me ndonjë tjetër që kishte të njëjtin mbiemër, apo se edhe ai kishte rënë në *dardhën* e së ëmës, po pa dijeninë e tij dhe i

te vënë tashmë në punë *laboratorin* e saj.

- Edhe njëherë, a ka munda si të ma qartësosh se kush është ky Guttenberg, që ta paska prishë gjumin e ç'lidhje ke ti me të, pastaj atë tjetrin që e paskësh çikrratë.

- Mirë e ka yt atë, - tha gjyshja.

- S'ia vlen. Sa gati i rri ti nëna?

- Ia vlen, ia vlen se edhe ne dimë diçka jo vetëm ai këshilltari yt më shumë se sa një ministër, - ironizoi i ati.

- Gjermani *im* quhet Karl-Theodor Maria Nikolaus Johann Jacob Philipp Franz Joseph Sylvester freiherr von und zu Guttenberg, shkurt, për ta mbajtur mend ju tani e tutje, Karl zu Guttenberg, - shqiptoi emrin me një saktësi të çuditshme e kujdes të jashtëzakonshëm, si një maxhodorm shumë i zoti, që njof-ton hyrjen në sallën e pritjes të ministrit, - është anëtar i aristokracisë së vjetër gjermane...

- Qysh e paske mbajtur mend tërë atë emër të gjatë si vagonat e një treni, - ironizoi sërish i ati.

- Çfarë s'të bën halli, baba! Gjermani *im* njërin gjysh e ka patur princ e tjetrin kont, edhe këta të dy politikantë profesionistë e të dëgjuar...

- Lëri këto, po ç'lidhje ka me ty, që të paska zënë lemëria?

- Ky Karli ka qenë nja tri herë min-

fare, qe nisur për të ardhur në kuzhinë, apo të flisnin më ngadalë që të merrte vesh edhe ajo se ç'thuhej.

- E po ky Karli sapo ka dhënë...dorëheqjen, - tha masterxhiku me një ton teatral, duke e rrokjezuar fjalën e fundit me një trishtim të thellë si të shqiptonte mandafën e vet, - dhe ky lajm po bën xhiron e botës, baba. Ka mbërritë dhe tek me dhe po merr erë...

- E pastaj?

- Nuk më pyete përse e ka dhënë dorëheqjen, baba, kjo është çështja, gjërat kanë rendin e tyre, - tha masterxhiku me një ton mentaro-masteri të kryer dhe zuri të bëjë ecejake nëpër kuzhinë si për t'ia kujtuar të atit zakonet e njohur të Leninit me ato ecejaket e tij dinamike e të rrëmbyeshme, që kishte parë dikur në filmat e dramat për të e ky për të qëmtuar ndonjëfarë ngjashmërie preokupimesh të mëdha.

- Pres të na e thuash ti, pra.

- Tanë këtë frikë s'e ka kot djali, ma ndjen zemra mua. Të kam thënë, mor bir, ti diçka iu ke bërë *keçtyre*, se ata kot nuk të kanë bërë ty të madh, drejtor të madh fare në këtë moshë që ke ti, ma ndjen zemra mua...

- Nëna, mblidhi këto gjëra mbi tryezë, të lutem, se s'dua të ha, - tha masterxhiku, pa guxuar t'i thotë troç gjyshes në sy të atit shihni këto punë të shtëpisë gjyshe dhe mjaft janë për ty në këtë moshë, të dalin e të





teprojnë dhe mos u përzie në muhabetë të tilla burrash. E kishte fjalën dhe sjelljen e rëndë e cinike, natyrisht jo me të gjithë.

- Guttenbergu dha dorëheqjen vetëm se, u akuzua për plagjiaturë pasi në disertacionin e doktoraturës së vet, kur e kishte mbrojtur atë vitë të shkruara, më saktë në 2006-ën, u gjetën ngjashmëri të theksuara me një artikull të botuar në Frankfurter Allgemeine Zeitung në fundnëntorin e 1997-ës. Por, eh këtu ka gabuar rëndë, i gjori, nuk ka cituar burimin, i ka marrë pa leje, m'i thënë shqip, troç. Leshkoja!

- Si?!  
- ...  
- Për kaq?  
- Universiteti i Bayreuth-it, ku mbrojtë disertacionin e revokoi atë dhe Guttenberg u detyrua të japë dorëheqjen...

- Vetëm se kanë gjetur ngjashmëri të theksuara me një artikull të botuar?!- sikur s'po iu besojë të atit.

- Hë, pra këtë nuk e di fort mirë; e ka bërë se ka harruar, apo me ndërjegje, kjo është punë tjetër, që do ta shkoisnin të tjerët dalëngadalë, por ama dorëheqja tashmë është një fakt i kryer, ka marrë dhenë, derisa ka mbërritë deri te ne. Ai s'është më Ministër Federal i Mbrojtjes i Gjermanisë dhe, sipas mendjes sime, zor se ngre kokë më... Sikur s'i njëj gjermanët sa skrupulozë që janë?! S' të fallin ata!...

Një copë herë at e bir u përfshinë në një bisedë, të cilën s'e kishin bërë kurrë më parë kaq hapur e me një seriozitet të tillë. Pasiguria e përciptshmëria në njohuritë për dukurinë, si të shkëlqin në një tokë të panjohur, i jepte një frymë diletante e pak si të frikshme bisedës së tyre. Njëri fliste se ç'dinte për plagjiarizmin në shkencë, po dhe në letërsi e në arte, tjetri e shihte si të ishte një dukuri e vjetër dhe e përbotshme, e cila ishte shpeshuar dhe kishte tërhequr më shumë vëmendjen e të gjithë atyre që ishin në anën e njërzëve progresistë, që kërkonin ta frenonin veçanërisht pas zbulimit të internetit.

Frontin kundërshtues nuk e shihnin si mundësi depërtime e rrezik të menjëhershëm dhe të lidhur drejtpërdrejt me ta. Interneti e ka bërë plagjiarizmin më të mundur, më të përhapur si epidemi, por edhe më lehtësisht të identifikueshëm, tha masterxhiku si të ishte ekspert i fushës. Përciptshmëria e njohurive dhe shikimi si një e keqe jo e vogël, s' depërtonte dot në vendin e tyre, i jepte bisedës një frymë teorike, si të kishin lexuar në facebook ndonjë lajm të bujshëm të ndodhur në ndonjë cep të botës dhe s'kishte kurrëfarë lidhjeje me ta. Nuk e cekën fare plagjiarizmin si pandershmeri, si vjedhje e pronës intelektuale të tjetërkujt, se përndryshe do të dilte të merrreshin me veten, me

shfrytëzimin e punës të tjetërkujt, duke i shtrembëruar burimet e shfrytëzuar.

I ati vuri re se i biri ishte thelluar në heshtje në njohuritë për plagjiarizmin, por si për shumçka tjetër e shihte jash të vetes, sikur ndodhte kudo gjëkë, po vetëm atij jo, sikur të ishte i imunizuar nga kjo e keqe e madhe e kohës. Ja, te citimet, që janë të domosdoshme për të provuar autenticitetin e temës, e shkëlqim, tha masterxhiku, duke u rropatur të fshihje dëshpërimin a pengun, sikur temën ta kishin patur të përbashkët të dy me të atin, duke i nxjerrë këshutë kokën merakut të vet jo të vogël, ose aty ku e dinte mirëfilli se kishte shkelur në dërrasë të kalbët. Vetëm se nuk u dorëzua fill e të thoshte copë "Baba unë jam një Guttenberg shqiptar!" Kur kjo dukuri ndodh në universitetet e Gjermanisë përfytyro se ç'situatë mund të ekzistojë të ne, në universitetet tona, që kanë mbirë si këpurdhat pas shiut, desh ta qetësonte i ati, si t'i thoshte se publiku i përgjumur dhe halleshumë e në kufijtë e ekzistencës, do të zgjohej vonë, për të mos i toleruar më shkeljet të tilla, sidomos nga politikanët e tij.

- Ky princ, duke qenë i kamur si ai, me prona e ç'po të duash, ç'dreqin ka dashtë që ka shkuar të bëjë doktoraturë e mastera? Ç'i duhen diplomatat?

- Baba, më duket dr po i pret drutë shkurt, apo je duke i rënë pragut, e ke me mua? Është ndryshe atje, e di mirë ti; ata dhe pse kanë lindur me para e kanë gjithçka, si ky *Guttenbergu ynë*, i vënë qëllim të lartë e të fortë vetes dhe harxhojnë vite të tëra të jetës së tyre, duke bërë shkolla e diploma dhe duke mbrojtur doktoraturat, - të vërteta, - që pastaj me anën e këtyre të punojnë e të bëjnë para për të jetuar më mirë...

- Shih, shih sa mirë që i ditke, qerrata! Sikur e ke lexuar në ndonjë gazetë tonën. Zaten jeni mësuar kështu, asnjë referencë, Ç'lexoni i kumtoni si mendimet tuaja. Të paktën kujtoja emrin këtij të mençuri, për respekt. Po ti ç'ke atëherë që trembesh, hane Shan, hane Bagdad i thonë kësaj!...

- E, po te ne ngjet ndryshe; ne më parë bëjmë para, pastaj blejmë diploma...  
- Mos e jep veten kështu. Ky është thjesht një lajm, ti po e përjeton si një mandatë për ty, si vendim të formës së prerë në tre shkallët e gjyqësorit!...Ti e ke lëshuar veten dhe dukesh sikur nesër do të gesh mbi tryezë të punës një letër të bardhë dhe ministri të të kërkojë të shkruash dorëheqjen tënde si të jesh i

lidhur në seri me këtë Karl zu Guttenbergun, apo si po i thonë më gjatë? Ka prapë edhe ndonjë tjetër? Mos more! Edhe Presidenti hungarez kështu? Si quhet? Pal Schmitt? Ç'ka këtu për t'u shqetësuar kaq? Ndoqe universitetin? Po. Nise punë? Po. Mbrojte masterin, sipas rregullave të kësaj kohe? Po...Ti s'mund të shpikje rregulla të tjera...Si është vendi bëhet kuvendi!...

- Sikur s'e di ti baba?  
- E, ç' të dijë unë tjetër, mos më luaj mendsh?

- Se qysh e bëra masterin, se kush më ndihmoi, se nga kush e tek kam marrë pjesë të tëra e çfarë kam marrë konkretisht e si e kam tëholluar kopjimin, si i kam përdorur burimet teorike të cituara, cila është saktësia e tyre, nga dhe kush m'i përktho mu në njëmbëdhjetë gjuhë të huaja ...  
- E pastaj?

- Më keq se ministrit Guttenberg do të ma bëjnë, e di mirëfilli, jam i sigurt, ke për ta parë...S'e besoni, ë?! Ja, këtu do të jemi. Do ta bëjnë një shembull këtu...Pastaj tjetrin. Ku këputet peri, thonë? Ku është më i hollë...  
- Ti në qoftë se s'iu ke bërë ndonjë gjë të mbrapshtë këtyre, në qoftë se s'ke marrë në qafë kënd s'ke përse të kesh frikë. Është bërë djali sa një grusht për një ministër gjerman e president hungarez, sikur ç'e ka gjetë, i ka hyrë frika në palcë. Ti s'je bërë kështu as kur e pate zënë atë çupën me dashnorin e dytë të saj?!...

- Ti gjyshe nuk ke nga t'i dish të gjitha, mos i ngatërro kotsëkoti gjërat, krejt pa lidhje; në këtë rast po flas me babin, - uli tonin, si të qe penduar me sjelljen e deriatëhershme të vrazhdë e pa kontroll fare ndaj gjyshe, që e kishte mendjen qefull, si i thonë s'kishte. Nga dhoma e gjumit, si dukej, e ëma s'kishte asnjë vërejtje për çka po dëgjonte, pasi s'po jepte asnjë sinjal.

- Po ç'ke përse bëhesh merak? Punove dhe e bëre masterin, s'e di unë ç'ke hequr? Ç'ka këtu për t'u qederosur apo bën vetë, sikur të ka hyrë lepuri në bark? Si ti janë pajisur me doktoraturë, mastera, specializime e diploma aq shumë njerëz në këtë vend, madje vetë deputetët në radhë të parë, ligjëvënësit, - do t'i zë emrat një nga një? S'i lexoj unë gazetat përditë? besa ndonjëri, që ka mbërritë të bëhet dhe ministër, edhe pa mbaruar shkollën e mesme...Nëntë deputetë, madje juristë, janë bërë të tillë, - nëse, - duke kaluar nga tëvjetçarja e drejt e në universitet privat, natyrisht që privat. E si thua ti do të nisë tani ndonjë fushatë kombëtare për t'ua hequr të gjithëve gradat e titujt shkencorë, në qoftë se i hyjnë kësaj pune? Ia paskan hequr një pedagogu në Fakultetin e Shkençave?! S'ma merr mendja se do t'i marrin mbarë, se ndryshe do të bëhej një katrahurë e vërtetë që s'do ta marrë vesh i pari të dytin, skandal do të bëhej, do të qeshte bota me ne. Po është rradhë e madhe, mor bir?! Aa, tani e tutje, po, të kenë mendjen... Ke për të parë, kur të nxjerrin këta tanë edhe legjislacionin, se për këtë janë të vetmit, po jo me fuqi paravepreuse, jo se nuk kanë luajtur menç, besoj, s'kanë leverdi për veten e tyre.

Më vër vesh se ç'po të them, shih bëji hysmet punës, drejtorllëkut, se ata që i rrinë strikt bindjeje të tyre po janë pa punë, edhe me familje e fëmijë, - na dëgio edhe ndonjë këshillë tonën, se diçka dimë, - pa për këtë mos e vrit mendjen...Koha është një shoshë e madhe që punon non stop njëzet e katër orë, sit e sit, sit e sit...  
- E parandje, do të më denoncojnë të parin. Ke për të parë. Mezi presin, sidomos njëri, ai...  
- Ish-kolegu?  
- Po, po ai. Paskesh qenë tëngjill i mbular, inatoqer i madh, hakmarrës...Nuk ka dalë vetë haptaz, i tunduri. Kështu në parqitje duket sikur nuk ndjehet, si një burrë zotëri që është pajtuar me fatin e pafat të tij, - vetë më ndihmave me vëllanë e presidentit, që ta hiqin qafe nga dikasteri, - po nga ana tjetër të përcëllojnë po t'i biesh në dorë...Në fakt s'ta përton. Baba ka njerëz me principe, po ne na duken si jashtëtokësorë...Kur nuk ka pyet fare për vite të tëra për *Njeriun e Shpresës së Bjerrun*, të cilin s'ka lënë rast pa e goditur brinjë për brinjë në gazeta, le më ne të

vegjëlve...Të përcëllojnë të tjerët; ata janë më keq, po ç'e duan mor zot, e respektojnë, u ka ardhë keq, gjoja, se e hoqën nga ne; e mbajnë edhe personalitet...Se mos e hoqa unë? U bë ristrukturimi i dikasterit dhe ai doli i tepër, ja kaq ishte, ç't'i bëja unë, ta ndaja rrogën me të...Pastaj nxori atë batutën e famshme, - se është i vetmi për to dhe, sa shpejt që përhapen, si zjarri, - se kjo e ashtuquajtura reformë e të djathtëve të majtë ishte hiq një kal nga puna dhe vër dy gomerë! E kanë mësuar dhe këta *ndërkombëtarët*, një e dhe e përdorin si pa gjë të keq. Edhe në Bruksel e kam dëgjuar njëherë. Sa u fyen kolegët!

- Ti sikur ke thënë që ai e kishte statusin e nëpunësit civil, ndërsa ata që mbajtën në punë asnjëri? - Ia bëri gjyshja.

- Nga nisesht? - rilidhi sërish bisedën i ati me një merak të ri tashti, pa pritur të kthente përgjigje i biri.

- Sikur ma ka dhënë një sinjal të fortë publikisht sot në një gazetë të përditshme. Dhe, s'ka dalë vetë, as nuk ka zgjedhë doko, po një analist personalitet, - kij inat, po jepi hakun, - që as ai s'të fal sekondën, antikongormist, që s'merr parasysh kurrëfarë rreziku. Se nuk është pa rrisik ta sjellësh këtë rast do të thosha unikal në realitetin shqiptar. Nuk u mjaftuan thjesht vetëm me një lajm, po e rrimoan enkas; ju duhet përqsja me ne; ju duhet për t'iu rënë këmbanave të alarmit, sipas tyre. Vetë *Njeriu i Shpresës Bjerrun* e ka halë në sy atë analistin, - janë disa si ai, që ku s'i futin hundët, për gjithçka janë kompetentë, gjithologë u thonë me të tallur, - e di mirë unë, ma ka thënë vetë ai që ju nuk e honepsni më dot, këshilltari!...

- Mund të jetë një rastësi, - desh ta qetësonte i ati. - Të është bërë ferra Ibrahim, mor bir, - shtoi.

I biri edhe pse po i afrohej të tridhjetave ende s'qe as i qartë dhe as i bindur; se vitet më të mira të jetës së njeriut janë ato kur vendos vetë që problemet e tua janë vetëm të tuat dhe s'mund t'ia hedhësh fajin askujt tjetër përse ato ngecin, përse nuk përparojnë, përse nuk shkojnë në kahjen që synon apo, akoma më keq, përse theqafen. Ndjente qeardhje, po edhe e brente ndërjegjia aq sa herëherë e quante veten fajtor para të birit për tutelën e gjatë *inkubatoriane*, - kështu i thoshte, - herë të dukshme e herë të padukshme, kur do t'i bënte qartë e më qartë, se ishte herë njëfarësoj pengese për të birin, në mos deformacioni. Djali s'kishte mbërritur ende në atë fazë pjekurie, që ta kuptonte se ishte vetë ai që e kontrollonte fatin e vet dhe askush tjetër.

- Rastësi këtu te ne? Jo, baba, veç rastësi nuk ka...

- Për atë e ke fjalën, e di unë, prandaj je trembur paq. Ai që të kishte në këmbë të të birit, që i studentin jashtë diti, të më të atë, s'latë gur pa luajtur dhe tinëzishit e nxorët në rrugë të madhe në atë moshë, pak vjet pa dalë në pension? S'kanë thënë kot, atë që s'do të ta bëjnë të tjerët, mos ua bëj ti. Thonë edhe ndryshe: kur do t'i bësh gropën tjetrit, bëje gati dy, edhe një për vetë, se një ditë do ta shohësh veten brenda.

- Gjyshe, të lutem, - ngriti zërin masterxhiku. Veçse nuk i tha "Mjaft më, i njëjti avaz tash sa vjet! S'të mjaftojnë punët e shtëpisë?"

- Mama, si thua, të rrinte im bir pa punë? - e mbrojt i ati.

- I ka hyrë në hak keq tjetrit, sa s'ka ku të vejë më. Kap njerin e kap tjetrin deri sa ia gjetët rrëfënanë me vëllanë e presidentit, edhe do lekë dhata...Po ne rrogë e kokë ishim, ai po me një rrogë mësuesëje e me dy fëmijë që i studentin jashtë, studentin e punonin për të fituar jetën me djersën e ballit; ky po i ri që edhe mund të gjente punë ndokund më kollaj se ai në atë moshë...Më vjen turp, kur e çoj nëpërmend të shkretin. Kur patët nevojë për të e nxirrni prej kreje të dy, babë e bir: s'ka si ai, do ta ftonit edhe në dasmë po të bëhej, pastaj i futët stërkëmben...Unë ty të kam nip, po kam qenë gjithmonë me të drejtën dhe atë e dalloj lehtë, me kini merak, paqka se po i bëj tëdhtëjtë vjeç...Me ndërre *dollari*, të parët do t'i përgallani atij si macja, sikur s'ka ndodhë asgjë...

(vijon numrin tjetër)

## P

## POEZIA



NGA MARJORIE AGOSIN

## Dëgjomë Anne Frank

për Xhoni

Më dëgjo Anne Frank me të vërtetë besove se të gjithë njerëzit janë të mirë? edhe pse ngjitur me ty ata po digjnin pyjet që u përcelluan në pellgjet e ëmbla të syve të tu. Edhe pse ti nuk urinoje dot pa rënë nata e zezë pisk sepse urina e një vajze Hebreje do lërhiqte vëmendjen e rojeve dhembë-rënë që prisnin si e si t'i zinin pusi kujtesës sate të brishtë.

Anne, pra ti vazhdon të më thuash që megjilhatë ka ende njerëz të mirë në këtë botë që ata asnjehere nuk të spiunuan ndërsa të sillnin lapsa që të shkruaje, fletore dhe iluzione të semura.

Por dëgjomë edhe mua një herë Anne Frank duket se për ty mjaftonte kaq, të mund të shihje mes hek-urave të çarkut të miut të mjaftonte të rregulloje floket e pagjuma të mjaftonte të këqyrje qiellin të shihje edhe pa i parë shishet e kaltra si peshq, që e bënin drejtimin

e reve

të zgjohej nën fishkëllimën e ndonjë Ujku të Lig të Madh sepse ti, ti ishe gjithmonë e dashuruar me gjithçka ngaqë gjoksi yt rritej delikat dhe i butë si tymi.

Anne Frank gjeja më kthjellët që kam lexuar ndonjëherë prej tëje në fletoren që mbaje nën krahun tënd të uritur fletorja me pikturat e Greta Garbos e rrethuar nga fjalët: "unë ende besoj se njerëzit janë të mirë në shpirt. Pastaj dikush mori vesh se po atë ditë ata kishin bërë shk-rumb pemë dhe Hebrej në çastin pikërisht që ti po thoshe: "unë duhet t'i mbaj idealet gjalle sepse ndoshta do vijë koha kur do mundem t'i shoh të vëna në jetë".

Anne Frank gjeja më e guximshme tek ty kur grupi i xhelatëve idiolë të preu veshet si për t'u tallur luajti bixhoz me mitrën lënde të sapo-zgjuar bixhoz kasapësh dhe gjaku të mpiksuar ata të zhveshën kokën nga floket që të dëfreheshin edhe më shumë vulosën sytë e tua bosh.

Por goja jole nuk u tha si një shkretëtire në mes të pajalësisë së tiranëve (dhe mua më vajti mendja tek shkretëtira e Atakamës dhe një vajzë e vogël që sapo lërheq dorën nga uji i burimit) mua më vajti mendja tek Lonquen-i dhe tek paturpesia e pafund e gjenjshlarëve (Lonquen është një furrë që i ngjan furrit ku nëna jole vdiq, dhe gjithë vellezërit dhe shokët e tyre).

Anne Frank m'u përgjigj nga varri yt i kalbur mes krimbave me të vërtetë besoj se ka njerëz të mirë edhe kur po humbe floket, edhe kur po capitje këmbëzbathur në ajër, duke këqyrur akoma qiellin?

Ky është një cikël i propozuar të "Milosao" nga publicisti i njohur Gazmend Kapllani, që edhe i ka përkthyer vetë këto poezi...

## Për autoren...

Lindur në një familje anëtarët e të cilës i kishin mbijetuar pogromeve dhe holokaustit, Marjorie Agosin (1955) u rrit në Kili në një familje Hebrejsh poliglote. Siç shkruan në një nga esetë e saj: "Babeli i gjuhëve që dëgjoheshin në shtëpinë tonë, më ndihmoi të meditoja mbi domethënien e gjuhës dhe të Diasporës. Qysh në femini kuptova se sa lehtë gjuhët udhëtonin nga një vend në tjetrin, duke hapur e mbyllur kufij. Por kuptova gjithashtu se gjuha e femijërisë ishte gjuha më e bukur dhe vendi më intim i kujtesës dhe dashurisë". Edhe pse të gjithë librat e saj janë shkruar në Amerikë – ku ajo jeton dhe është peda-

goge në një nga kolegjet më prestigjioze të Amerikës, Wellesley College – Marjorie Agosin vazhdon të shkruaj poezi në spanjisht, mandej duke e përkthyer vetë në Anglisht. Autore e dymbëdhjetë volumeve poetike, dhjetëra eseve dhe kritikave letrare, Marjorie Agosin është nderuar me shumë tituj letrare prestigjioze. Në vitin 2000 qeveria Kiliane e nderoi me Medaljen e Lartë Gabriela Mistral (e cila u jepet krijuesve më të shquar në historinë e vendit).

Unë jam takuar për herë të parë me Marjorie Agosin në vitin 2013, në Librarianë J.F. Kenedi në Boston. Ishte një takim që u zhvillua në një miqësi të mrekullueshme. Pasi lexova disa nga volumet e saj poetike, i shpreha dëshirën që të përkthej disa nga poezitë e saj në shqip. Në fakt, kjo është hera e parë që përkthej

poezi në shqip që nga adoleshenca (aty rreth vitit 1983 më ra në dorë pothuajse rastësisht një libër i ndaluar i Zhak Preverit me poezi, "Paroles", që përktheva nga frëngjishtja në shqip). Kur i thash Marjorie Agosin që kam ndër mend të përkthej disa nga poezitë e saj u lumturua e tëra. "Poezitë e mia në shqip janë ëndërr", tha gjithë mirënjohje. Edhe pse nuk ka qenë kurrë në Shqipëri deri më sot, Shqipëria ka një vend të veçantë në imagjinatën dhe mendimin e saj. Qysh e vogël, në Kili, ajo ka njohur hebrej Europianë që kishin mbijetuar duke u strehuar në Shqipëri.

Fjala Shqipëri, thotë Marjorie Agosin, u sjell asaj dhe shumë Hebrejve vetëm kujtime të ngrohta dhe ndjenja mirënjohje.

## Kushërinj

Nëna ime pëshpëriti duke përmendur emrat e tyre, Julia, Silvia, Sonia, Sonia, Julia Silvia. Ishin emrat e lumenjve, emrat e zanave. Ishin kushëritat e mi, gra që i njihnim, me të cilat kishim ndarë një histori të përbashkët. Unë i desha ato nga larg dhe nga afër.

Në nuk dimë asgjë për to, pakëz fare u morr vesh rreth kohës urdhruese të luftës, vetëm ca grimca, një mëmeritje, një psherëtimë. ato na dërguan adresa të maskuara në kode, që nuk i deshifruam kurrë, gjurmë të rreme, emra të padukshëm.

Në festat fetare, karriget e tyre ishin bosh dhe im at, me kupën e tij të shenjtë, thërriste emrin e tyre, Julia, Sonia, Silvia.

Unë gjithashtu i desha, isha e lumtur akoma edhe duke parë format e germave që kishin shkruar me duart e tyre, në kartolina demode nga Vjena, pastaj Praga, dhe më vonë, nga qytete me emra të rreptë.

Gjyshja ime, Helena, fjalëpakët, i morri fotografitë e tyre, që i ngjanin eshtrave ngjyrë-fildishi, dhe ndriçonin në mungesë. Befas, pothuajse pesëdhjetë vjetë, më vonë, kushërit nga Suedia merr në telefon, dhe s'ka se si nuk i sjell në kujtesë.

Ai na tha, pothuajse pa thënë asnjë fjalë, qellor prej largësisë, se i kishte parë, ato kushëritat. Julia, Sonia, Silvia. I kishte gjetur në Librin e Shenjtë të të vdekurve. se kishte kërkuar për mbiemrat e tyre, dhe gjurmët e tyre.

Ato ishin shpërngulur tek ato trenat e hijeve dhe të grave pa floke, duke kënduar në fustanet e tyre ngjyrë-qielli,

në Terezin, pastaj, ishin dërguar në Auschwitz, atje ku nuk shpëtoje pa t'a regjistruar emrin, atje ku nuk ishtë kalendare, atje ku kujtesa nuk ekziston, atje ku nuk banojnë zëra njerëzish, atje ku gratë prisnin pabzanun, ku prisnin të qethura, dhe duke folur me vete dhe mbanin mbi kokat e tyre ritualt e zogjive të vdekur.

Kushërit nga Suedia i gjeti. Kishin vdekur dhe ende jetonin ose më mirë të themi arritën në një pasditë të pruar, të plagësura dhe të vdekur.

Ai më thotë ngutasi se ata i vranë kushëritat me gaz ngjyrë-blu dhe se kjo është e vetmja gjë që ai di për to. Ai më thotë që t'ia them nënës sime dhe Halles Regjina gjithashtu.

Të gjitha ato në Auschwitz, dhe unë nuk e di si t'i thërras, dhe unë nuk di si t'i kujtoj.

Tërbimi shkrihet me kllithjet e mia. Unë i njoh ato Sonia, Julia, Silvia. Por nuk i thërras dot më me emrat e tyre, unë i shoh se si i rreshtojnë një-nga-një në ato pyjet me fluturata të vdekur dhe mendoj se unë nuk e meritoj të jetoj pa to.

I them nënës sime dhe gjyshes i them, e cila ka mbetur e harruar në Jug, se nuk duhet më të kërkojmë për to, mos të imagjinojmë më ogure të rreme; se ato janë këtu; se sapo mbërritën në kamp ata i dogjën trupat e tyre: eshtrat e tyre të holla u hodhën pa emra në furrat e vogla të vdekjes.

Ndjem fatkeqe kur të rrefej këto histori prandaj mund t'a rrefej vetëm në një poezi sepse nuk ja them dot kujt. Nuk dua të dëgjoj gjëra të tilla "prapë, këta Hebrej të duhej t'i kishim të mirë" "keto gjëra ndodhën shumë vite më parë". "s'marr vesh nga keto gjëra". Kështu pra folën kur fqinjët, gjyshi, nipërit e tij u zhdukën.

Sonte Të gjitha këto vëritën në kokën time si një kapulë lulekuqesh të vyskhura. Nuk di ku gjenden trupat e tyre, Julia, Sonia, Silvia.

Duhet t'i bie mes për mes këtyre livadheve. Pasoni im do puth barin duke pritur të lakoj buzët e tyre.

Julia, Sonia, Silvia, Nuk duhet të vdisni të rrethuara nga tela me gjemba. Nuk duhet të mbeteni Hebrej të Ishehur pa flokë dhe pa gjuthë.

Do kthehem sërish tek lëndinat t'i ujis me lutje dhe ujë të bekuar. Duhet të dhuroj një ditar, Julia, një erashke, Sonia, një frymëmarrje drite, Silvia. Kushëritat e mia, kushëritat gjaku, familje që nuk kam me mundësi t'ju them se ju dua. Nuk dua gënjeshtër rreth emrave tuaj. Nuk dua askënd të flasë në emrin tuaj. Kërkoj vetëm një sekondë, një shekull paqë dhe kujtesë për të gjithë Hebrejtë, e vdekur dhe për çiganët e vdekur, dhe për gratë e Bosnjës. të gjithë ata kanë të njejtat emra, Julia, Silvia, Sonia, janë të gjithë ata kushërinjtë e mi.

I.N.

## Gratë e Sarajevës

Në Sarajevë bora end shtigje të brishta, në anë të rrugëve, duke lenë gjurmët e përgjakura, te dukshmerinë e veshtrimit të saj bosh. Bie bore në Sarajevë,



## ...nga numri i shkruar

Numi i "Milosaos" së këtij numri ishte relativisht i mirë. Shkrimi kryesor i takonte Gjon Markut me argumentin për bibliotekat më të vjetra në Shqipëri. Gjurmët e para që paraqesin interes dhe që flasin për vende ku ruheshin dhe grumbulloheshin libra pa diskutim mbeten qendrat e mëdha kishitare, sipas tij, por edhe që është lehtësisht e marrshme me mend. Autori përmend Shkodrën apo Drishtin, Kryepeshkopatën e Ohrit, Metropolitë e Prevezës dhe të Kosovës. Këtyre u shtohen edhe Metropolia e Durrësit apo Episkopati i Elbasanit, të Apollonisë, të Vlorës, të Lezhës, Metropolia e Janinës, Episkopati i Gjirokastrës, të Drinopojës, të Himarës, të Butrintit, të Artës etj., të cilat zënë fill herët si qendra të mëdha dhe të përmendura kishitare dhe kulturore... Gjon Marku punoi mirë por problem mbetet mënyra e artikullimit që duhet të jetë më i njëtrajtshëm dhe shqipja duhet të jetë më standarte, nëse do të shkruaj me këtë variant.

"Pas Guttenbergut një filxhan çaj me kamomil" është titulli i një tregimi gati novelë të Kujtim Dashit për "Milosaon", që do ta vijojmë dhe në këtë numër. Autori sjell një realitet të ditëve tona me personazhe gati reale, duke na afruar me paradokset e kohës ku jetojmë..., shkroi redaktori, por që mund të ishte pak më i shkurtër dhe me më shumë frymëmarrje të ideja.

Shkrimi publicistik i Krenarit ishte shumë interesant. Ndoshta pasuria e vetme,

pastërtisht legjitime, që ka lënë Kolombi, mbetet vendlindja e tij, Gjenova. E tij po aq sa e Mazinit dhe e shën Gjergjit (me të cilin shqiptarët i lidh më shumë se thjesht një emër). Është për hir të këtij qyteti dhe ndikimit të frymës së tij në të, që Italia vijon të thirret "paese dei santi, navigatori e poeti". Qytetit që vijon të pëllë Montale, de Andre dhe poetë të muzikës së lundrimit, si dhe të bujtë si banorë të saj rëfyesit e mëdhenj të qytetit, nga Petrarka të Dickens, Shelly, Bajron, deri të Virginia Woolf e me radhë. Një vështrim tejet interesant në zharrin e letërsisë së udhëtimit, që e nderon autorin.

Redaktori shtoi diçka për autorin e librit "Gurët e vetmisë" që e vlerësoi jashtëzakonisht interesant, sa i përket zgjidhjes letrare. Banorët e trevës, që janë aty mes shokujsh, ndoshta nga ai brumi i vërtetë i Epirit, për të cilin zihen historianët e dy vendeve tona, tregojnë se në shumë raste i kalojnë edhe zakonet e zakonshme të grekëve dhe shqiptarëve. Janë konservatorë të mirë por aspak të tepruar, ashtu si e gëzojnë jetën me të gjithë mushkëritë. Por, diku u vigjilon një alert pabesie, ai, që njohin më së shumti njerëzit sot nga historia e tyre e jashtëzakonshme...

E theksojmë se ishte numër i mirë dhe layout punoi normal. Duhet të vërejmë se redaktori duhet të punojë më shumë me individë shqiptarë të artit dhe kulturës. Është detyrë.

të vdekurit nuk dinë ku të lypin strehë.

Bie borë në Sarajevë dhe dimri është si një zemër rrethuar nga hije të zeza. Shumë larg... shumë pranë hapet e njerëzve të gjallë që lidhin besën me të vdekurit. Gishi i një prej kufomave që vizaton zemra

II.

Në Sarajevë këtë dimër gratë përkëdhelin harpat e natës. Oerpiqët e natës. Ato ëndërojnë me frutat e Jugut, melodi të thyera, ato e ushqejnë velen me atë linqull të thellë prej pianos në mes të natës që mediton, natës që leviz për të perzënë të vdekurit.

III.

Këtë dimër do bjerë shumë borë në Sarajevë. Do bjerë borë me mosbesim në Sarajevë. Të gjallët do dinë pse dhe si të bëjnë dashuri, dikush do shkruaj poezi mbi kallkan sepse nuk do jetë në gjendje të artikulojë asnjë fjalë, sepse askush nuk do t'i shohë në tejdukshmerinë e tyre, sepse bora është një heshnje e shenjtë.

IV.

Në Sarajevë fëmijet gjithashtu vdesin dhe nuk vdesin në aksidente makinash. Bie kaq shumë borë dhe të vdekurit nuk dinë ku të lypin strehë. gratë përkëdhelin harpat



e natës.

## Jetë e re

Sonia Helena asgjë nuk humbet duke jetuar. Zgjidh pa përsosmërinë e rastësise, ritmet rrethuese të kthimeve pas dhe të profecive. Përpiqu dhe praktikko brishtësinë. Qendro me dy mendje përballë fatit. Ji bujare me tiranin, e rreptë në dashuri. Mesoju atyre të zgjasin një dorë dhe të varen tek iluzioni i thellësisë, që është lumturi pa ngulje. Meso të dëgjosh të vdekurit, dhe hapat e tyre si marshi i tangos.

Ji e ngrohtë me ata që qajnë, më të mërguarit, me ata që emigrojnë prej të gjitha qyteteve dhe gjithashtu beju të ditur se ata mbartin pasazhin e kombit në sytë e tyre.

Sonia Helena asgjë nuk humbet duke jetuar. Sic thoshte edhe Enrike, provo, të jetosh jetën sikur të ishte gjithmonë një rikthim tek vendlindja e valeve që s'bejnë shkumë. Mos u ngut sepse kemi sa kohë të duam.

Aleherë kur të viziton pagjumësia, kur lundron dhe je një hije e turbulluar, zgjidh poezinë sepse ajo, si edhe lutja, e dinë se si të jenë engjejt e tu mbrojtës dhe vargu do behet për ty një pendë në buzën e Zotit.

Më shumë se sa të mbijetosh, zgjidh të jetosh jetën me të gjithë rreziket e kobshme. dhuro zemërgjerë për zogjtë e tokës, pre gjelbërimin, trunget buzë greminave. Krijoi ritet e tua, ceremonitë e dashurisë. fshih të gjitha talismanët, zilinë dhe çdo vogëlsi të mundshme. Mos j k qaq e kujdesshme, ose kaq e rreptë me vetvelen, as mos uro të kesh aritje madhështore.

Mos harro se lumturia është vetëm një dorë, një psherëtimë, që të zgjat, një lule vjollce.

Asnjë nuk humbet duke jetuar Sonia Helena, duke provuar, Sonia Helena, bij, shoqe, zgjidh jetën.

## Balada e të mërguarit

Ki mëshire senjor Ekzekutues për refugjatin, atë që përdiqet pa asnjë arsye që do vetëm të shohë pasazhin e tokës së tij pranë vargmallit të Andeve t'i fershellejë ererat e fatrave fluturuese flokët e lara nga hëna të nënës së tij duke ecur me hapa të vegjël para e mbrapa, i përkulur paksa mes miellit dhe kripës.

Senjor, lere endacakun të kthehet të huajin lere çdo orë të ditës që të mund të luajë lojën e bretkosave, plotë gjallëri në brigjet e lumenjve të atdheut të vet duke përkshuar shpella të lara në blu derisa të bjerë në gjurmët e Maries dhe kujtimet e luleve të akacies.

Dëgjo senjor ti nuk do pendolesh për heshljen e autsajderit që sapo të hapësh e të mbylles sytë bëhet shurdh dhe pret fatin i humbur.

Senjor, lere të kthehet tek ballkoni i shtëpisë së tij tek qetësia e pulave tek lëndinat plotë lule limoni tek plehrat në rrugë tek çehra e ditës në tokën e tij.

## I huaj

Gruaja e huaj kërkon për një gotë verë ose uje, një cik toke. Pezulli, lakuriq përballë elementeve të mërgimit të saj, uji e sjell pranë jetës së botës së saj imagjinare, dhe ajo shpik një ishull të vockel, krijon një hartë, gjeografi, tatuazh i keqardhjeve të saj.

## Emigrantet

I. Ishim të zgjuar kur përgatitëm fluturimin të brishtë me gjindjen

tonë nëna solli copa toke të freskët t'a marrim me vete gura që t'i kujtojmë të vdekurit tanë që lamë pas ca fotografi pezull në degët e çakërditura të gjenealogjisë sonë një shandan me shlatë qirin që të ndriçojë errësirën e emigracionit.

II.

Në ikem me hapa fluturues duke përsëritur historinë e të tjerëve tani, neve ata na priten siç priten të huajt me mirësjellje të vakët me mosbesim të fshehur.

III.

Në mesuam të jetojmë mes gjërave të huaja të shohim ëndrra me lule-orkide ballkoni i shtëpisë pranë delit mungesa e albumit të kujtesës i zbuti keqardhjet tona, si puse të errëta në jetuam me duart tona të shtrira drejt mundësisë të horizonteve drejt ujërave dhe qiejve që nuk na përkasin pa pyetje as përgjigje ndoshta në ishim ajo fotografia e zverdhur nga koha pezull mbi një kalendrar pa orë as stinë duke u endur mes qyteteve mos mikpritëse duke kërkuar për strehë në kopshte dimërore.

IV.

Emigrante duke kaluar kufij të paepur duke përfytyruar gjeste në mungesë në distancën e të solmes, pas një kohe të gjatë në tokën e nxirë-kallkan ata mesojnë një ljetër mënyrë të ekzistuarit në një gjue ljetër ata përsërisin fjalitë sipas gramatikës përmasat e urrëjtjes dhe të civilizimit i mesojnë ngutasi dhe vetëm duke ushqyer ëndrën e rremë në vetmi, të huaj në tryeza boshë kujtesa është një bashkëtingëllore e re një zë që duhet shqiptuar vetëm ata përsërisin embel anglishtja i bën të ndjehen më të fortë dhe të vegjël në nostalgjinë e tyre të humbur, ata bëjnë ëndrra për fillimin e vjeshtës gjedhet e pemëve që ndryshojnë ngjyrë brishtësinë e fluturimeve.

R

REVIEW

Një nga autorët më të njohur sllavë shkruan për Ismail Kadarenë dhe një vepër të tij të përkthyer në Kroatisht, duke i afruar publikut të tij një shikim interesant për shkrimtarin tonë të njohur...

# Rusja në vendin që mezi mjafton për varret e banorëve të tij

NGA MILJENKO JERGOVIĆ

Ismail Kadare, shkrimtar i madh ballkanik, një prej më të mëdhenjve të Europës ende i gjallë. Jeton kryesisht në Francë dhe shkruan në një gjuhë e cila në kroatish nuk ka përkthyes letrarë, madje as në Zagreb në ekziston Katredra për gjuhën shqipe. Romani „Kukulla” është libri i parë në prozë i Ismail Kadaresë që botohet në kroatish.

Tregimin shumë të shkurtër, jo më shumë se një fare e gjysëm, të titulluar „Vdekja e ruses”, Ismail Kadareja e botoi në vitin 1981, kohë në të cilën Enver Hoxha ishte ende gjallë, ndërsa shteti në të cilin ai mbretëronte i mbyllur si kuti sardelesh. Është historia e një ruseje, nga fundi i jetës së saj dhe nga perspektiva e varrit, e cila në vitin 1959 u martua me një oficer të ushtrisë shqiptare. Udhëtuan për muaj mjalti në atdheun e tij, marrëdhëniet mes vendeve vëllazërore u ndërpre. Shqipëria u mbyll, dhe ajo mbeti përsosmërisht e vetme. Pikërisht për këtë vetmi shkruan Kadareja, dhe për kunatat, motrat e bashkëshortit të saj, të cilat e qajnë me hidhërim rusen e gjorë, „qajnë para së gjithash për vetminë e tyre. Por me siguri edhe për të sajën”.

Antarja e Kryesisë së Frontit Popullor të lagës mban një fjalim mbi varrin e saj ende të hapur, por në asnjë fjalë nuk përmend kombësinë e saj, „për të cilën edhe i ra mbi kokë vetmia më e madhe që mund të mendohej”. Në fund thotë: „Mirupafshim Nina!”. Dhe këto fjalë, pohan përkthyes, janë të vetmet fjalë të natyrshme që foli. „Por akoma më të natyrshme ngajné grushtat e dheut dhe gurët që kërcasin mbi arkivoli me një gjuhë universale, shumë më të kuptueshme sesa të gjitha gjuhët njerzore, megjithëse varrin për këtë grua të vdekur nuk e dha Rusia e pamatë, por toka e ngush-të e shqiptarëve, e cila mezi është e mjaftueshme për varret e njerzëve të saj”.

Kjo histori është e pazakontë jo vetëm për mënyrën e të shkruarit të Kadaresë, sepse në të duket sikur ka diçka autobiografike. Sikur, Zot më faltë, është vetë shqimtari Nina që po e varrosin, sikur bëhet fjalë gjatë gjithë kohës vetëm për të. I kufizuar dhe i murosor me gjuhën që askush në botë nuk e kupton, në vendin në të cilin përveç ndonjë miku anonim gjithësi të parëndësishëm-kjo nuk ka rëndësi, i fshirë nga konteksti stilistiko-gjuhësor, shoqëror, imagjativ për letërsinë e tij, shkrimtari ia krijon vetvetes kontekstin, përshkruan historinë dhe historinë e letërsisë së tij, nëpërmjet së cilës do të mund të kuptohen tregimet e tij.

„Vdekja e ruses” është publikuar para disa javësh në përkthimin serbisht dhe e botuar nga Samizdati B92 i Beogradit, në kuadrin e një libri me novela të zgjedhura, të titulluar „Bisedë mbi brilantet një pasdite dhjetori”. Në të njëjtën kohë, ndoshta në të njëjtën javë, doli në përkthimin kroatish romani i shkurtër autobiografik i Kadaresë „Kukulla” botim V.B.Z.-së. Çudia është e dyfishtë: në njërin anë çudia përbëhet nga fakti se në të njëjtën kohë janë botuar dy libra të një shkrimtari vepër të të cilit janë botuar shumë pak dhe në mënyrë të varfër në gjuhë tona, megjithëse puna për përkthimin e tyre ka filluar që prej më shumë se tridhjetë vitesh. Deri tani kryesisht në Sarajevë dhe në Beograd, ndërsa „Kukulla” është - po të mos marrim parasysh një pamflet politiko-kulturore, është libri i parë i Kadaresë që është publikuar në



Ismail Kadare

Zagreb. Ana tjetër e çudisë është akoma më e çuditëshme: përkthimi serb i novelave dhe përkthimi kroat i romanit është bërë i njëjti përkthyes, Shkëlzen Maliqi.

Në Zagreb, që nga kohët e Shullait, nuk ka patur interes për kulturën dhe letërsinë shqipe, kështu që nuk ishte e mundur të gjendej përkthyes nga kjo gjuhë, ndërsa në Beograd, pavarësisht nga armiqësia e thekur ndaj shqiptarëve, gjithësi ekziston fakulteti për studime në gjuhën shqipe, e për pasojë, është kreu e logjikshme, ka edhe përkthyes letrarë nga gjuha shqipe. Shkëlzen Maliqi, shkrimtar, folozof, dhe kritik arti, madje edhe politikan i përkohshëm, është beogradas i dikurshëm dhe pa dyshim përkthyesi më i mirë letrar i poezisë dhe prozës nga gjuha shqipe. Duke pranuar përkthimin e tij, në vend që të kërkohet më kot një përkthyes nga Kroacia, ose, çfarë është më e keqja, të vazhdojnë edhe më tej ta injorojnë Kadarenë dhe tërë korpusin letrar shqiptar, në Shtëpinë botuese V.B.Z. ndërmoren një veprim që në kushtet kroate mund të themi se është pothuajse revolucionar. Me këtë veprim u krye një precedent, le të shpresojmë, që do të shpjerë në ndryshimin e zakon-ëve, e kështu në të ardhmen do të zëvendësojë mungesën e përkthyesve letrarë jo vetëm të atyre nga gjuha shqipe, por edhe nga disa gjuhë të tjera. Përkthimi në serbisht i Maliqit, është i përpunuar pjesërisht dhe redaktuar brenda gjuhës standarte kroate, gjë e cila për nga pikëpamja e letërsisë dhe e së vërtetës mbi tekstin, atë origjinal dhe në përkthim, janë pakrahasimisht autentikë, të drejtë dhe të vërtetë, ndryshe nga ato përkthimet çalamane dhe të çuditëshme nga një gjuhë e tretë, kur, le të themi, vepër nga arabistja apo ato të shkrimtarëve norvegjezë përktheshen nga përkthimi në anglisht apo gjermanisht (gjë e cila në botimet kroate këtu vitet e fundit është rast i shpesh-të).

Kukulla është nëna e Kadaresë. Grua

e ftohtë dhe e distancuar, me fytyrën e ljer të ngjashme me ato të kukullave japoneze. Tregimi për të është historia e të rriturit në Shqipëri, gjatë Luftës së Dytë Botërore, vendosjes së rregjimit komunist, dallimet klarore dhe gjinore, e pastaj edhe historia mbi shtëpinë, e cila sikur të ishte një organizëm e gjallë, transformohet sa nga vitet e sa nga ndryshimet e epokave.

Janë të paqarta dhe të pasigurta dallimet mes Partiakatit dhe Matriakatit. Në bashkësitë fisnore, në territorin e maleve Dinarike, në vende si puna e Malit të Zi dhe Shqipëri, ku burrat vriteshin në luftë ose shkonin në kurbe, shpesh herë mbizotëronte figura e Nënës së madhe mbi tërë familjen e madje edhe mbi tërë fisin. Megjithëse të Kadareja nuk kemi të bëjmë me një rast të tillë, bëhet fjalë për një familje qytetare aristokratike të varfëruar por e cila ende mbahet disi në gjendje të mirë, ku fryma e Matriakatit ndjehet në mos asgjë tjetër, së paku në po atë kultin e nënës që përshkruan gjithashtu edhe Luan Starova në romanin „Erveheja”. Sepse të dy djemtë, presin më shumë nga nëna sesa nga babai. Në këtë pritmëri poetika e jetës dhe e rritjes në vetë agun e erës enveriane. Vetëm se njëra prej këtyre familjeve mbeti e mbyllur hermetikisht në Shqipëri, ndërsa tjetra u arratis në Jugosllavi, në Maqedoni. Do të ishte interesant leximi i krahasuar i këtyre dy romaneve...

Raporti mes nënës dhe të birit është tejet i poetizuar, i reduktuar gati në lojë. Kështu ndodh në jetën për të cilën flet ky libër. Në ndryshim nga nëna e tretë shqiptare historinë e së cilës e kemi lexuar, në atë prozën e madhërishtme „Shkëlqim dhe tmerr” të aktorit Bekim Fehmiu, Kukulla jeton jetën e saj e cila në një masë të madhe edhe jashtë jetës. Ajo në thelb nuk është e detyruar të bëjë asgjë, përçesë të mbajet parasysh me kujdes raportet e saj tejet të ndjeshme me familjen e të shoqit, dhe kryesisht është e paafte për çfarëdolloj pune serioze. Ose atij i duket kështu teksa rritet.

Një ditë, pasi i ishte botuar libri i tij i parë, dhe ky një libër me poezi, ajo fillon të pyesë e shqetësuar nëse ai është bërë i famshëm. Kurrsesi nuk do të donte të ishte i tillë, sepse diku kishte pas dëgjuar, se djali kur bëhet i famshëm ndryshon nënën. Ajo mendon se djemtë e famshëm nuk duhet të kenë të njëjtat nëna të zakonshme.

„Kukulla” është një libër i pazakontë, mjaft atipik, në korpusin e librave të përkthyer të Kadaresë. I shkruar pothuajse me lehtësi, pa shqetësim të madh për faktin se çfarë do të thotë bota për të, apo si do ta lexojnë kritikët, është libër i një shkrimtari i cili është afër fundit të rrugës. Sepse me të vëretetë që, shkrimtarit të lavdishëm që jo vetëm ia ka krijuar vetes kontekstin dhe traditën, por edhe është aq i njohur në botë, sa që në nevojitet më asnjë lëvdatë për ta ngritur dhe as një kritikë për ta ulur. Krahas kësaj, ai, fiksionalisti i vjetër, ëndërrimtar, krijues legjendash dhe shkatërrues i tyre, nuk ka më nevojë për të shpikur dhe shkruar, shpjegon sikur gjithçka ka ndodhur dhe jeta tashmë ka kaluar.

Libri fillon në muajin prill të vitit 1994, kur i vëllai nga Shqipëria e lajmëron shkrimtarin për vdekjen e nënës. Përfundon pesë vite më vonë, kur avionët e NATO-s fluturojnë mbi detin Adriatik dhe bombardojnë Shqipërinë. Shkrimtari ka në mend njëfarë ngashjimi fëmijëror ndaj bombarduesve dhe historia nga Lufta e Dytë Botërore kur vetëm një bombë ishte e mjaftueshme për të shkatërruar shtëpinë e tyre të madhe. Se çfarë do të ndodhë atëherë do ta marrë vesh ai që do të lexojë „Kukullën”. Ky detaj nuk duhet t'i prishë përjetimin exuesit.

Libri me tregime, përkthimi i të cilit është botuar në Beograd, dhe të cilin ia vlen të lexojë krahas me „Kukullën”, titullin e ka marrë nga historia e tij më e rëndësishme, e cila flet për ardhjen e një francezi si mik. Në darkë arrin edhe Zonja Vuksani me të bijën, emigrante, e afërt me oborrin e Mbretit Zog. Pason një prej tregimeve më të bukura që kam lexuar këto vitet e fundit, dhe në të cilin ka dy episode. I pari, më shumë violina në një ditë janë shkatërruar gjatë bombardimit në Dresden në vitin 1945, kohë në të cilën në më pak se një gjysëm ore janë bërë copë e çikë gjashtëmbëdhjetë stradivari dhe guarnieri, që të gjitha pronë e viruozit të violinës Fric Krejsler, çifut i dëbuar, i cili në atë kohë ishte shtetas amerikan. Dhe e dyta. Në njëfarë kohe, në gazetën shqiptare ia filluan të duken fraza dhe fjalë latine. Njerëzit e afërm me intelektualët e burgosur dhe elementët antishtet, menduan se nëpërmjet tyre, të burgosurit, fshehurazi, lajmëronin se së shpejti do të liroheshin dhe në njëfarë mënyre i informonin për këtë. Por asnjë prej tyre nuk u lirua. U liruan vetëm kriminelët, të cilët latinizmat i kishin dëgjuar në burg dhe u kishin pëlgjer. I nxorën jashtë këto fjalë dhe fjalë dhe ato u përhapën gjithandej. Në këtë mënyrë përfunduan edhe në faqet e gazetave.

Ja prandaj, është Ismail Kadare.

**“Botuar te „Jutarnji List”.**  
**Përktheu nga origjinali Xhelal Fejza**

Intervista në "News24"

# Shqipëria, një vend me politikë anormale

Nga Adi Krasta

(vijon nga faja 1)

...shqetësuar për situatën politike në vend, pasi është dramatike".

Kështu deklaroi gazetari e prezantuesi i njohur televiziv Adi Krasta, i cili këtë vit është bërë pjesë e skuadrës së "News24", pasi ka lidhur një kontratë të re bashkëpunimi me këtë televizion. Ndonëse nuk shfaqet shpesh nëpër intervista televizive, Krasta këtë herë ka 'thyer' rregullin.

I ftuar në emisionin "Kjo Javë" në "News24", Krasta ka komentuar situatën politike në vend, duke u fokusuar tek zhvillimet e fundit, që nga dorëheqja e Fatmir Xhafajt nga posti i ministrit të Brendshëm apo dhe dalja publike e ish-ministrit Tahiri.

**Pse nuk jep intervista shpesh?**

Që t'i përmbahesh dëshirës për të folur vazhdimisht, që të dalësh të flasësh atëherë kur duhet, tregon fuqi karakteriale. Kam ndonjë reaksion për të thënë ndonjë gjë, ti e përmban veten. Është marrëdhënie që vendoset me veten.

**Sa larg dhe aq afër zhvillimeve...një skaner tëndin e ke. Do doja të pyesja për atmosferën politike. Si e sheh?**

Optika... dhe këtu të vjen shpesh për të qeshur, në diskutime që bëhen në studio televizive për të njëjtin fakt që thotë dikush; nuk është i vërtetë, ky është perceptimi yt'. Perceptimi shpesh herë ka prodhuar përfundime spektakolare në zgjedhje. Në këtë optikë, unë jam jo vetëm i lejuar, por kam përshtypje si një publik i specializuar që jam, ta shoh me shqetësim të madh, dhe të ndjek çdo gjë që ndodh për t'i ballafaquar të gjitha dhe për të mbërritur në një konkluzion të arsyeshëm. Situatën politike në Shqipëri e shoh të vështirë, nuk rrotullohem duke gënjyer veten. Situata është dramatike, gjendje e njerëzve është shumë e paqëndrueshme.

**Flasim për një ministër të dorëhequr dhe një kryetar bashkie të Durrësit, që i kërkohet të dorëhiqet... Meta që nuk po dekreton ministrin e ri të Brendshëm...**

Vepimet në përgjithësi, aksionet qeveritare një njeri mund t'i shoh me analizën për të parë vendimin të shkëputur nga rrethanat dhe ndjeshmëritë. Unë për hir të vërtetës nuk e bëj. S'jam njeri i politikës. S'flas në tv për t'u votuar, por për t'u kuotuar. E njoh publikun tim. Aq pak sa për të kuptuar që dorëheqja e ministrit të Brendshëm të një vendi është një ngjarje e rëndësishme. Dorëheqja e dy ministrave të Brendshëm është një tregues doktrinar i sjelljes së njerëzve ndaj kriminalizimit të vendit, kanabizimit. Kjo është ngjarje e rëndësishme për mua. Variacione mbi temë, spekulime, nuk bëj. Unë kuptoj se dorëheqja është e rëndësishme dhe tregon për problematikë dhe krizë qeveritare që mund të zhvillohet në përfundime nga më të ndryshmet. Kjo dorëheqje për vendin tim tregon



për një krizë të mirëfilltë qeverisëse.

**Doja t'ju pyesja për rastin 'Tahiri'. Gjykoni se duhet të rikthehet Tahiri? Ç'të vërtetë shihni tek ajo e 'vërtetë e tij'?**

Të vërtetat janë situata shumë kokëfortë, dhe kanë nevojë për gjykime të forta dhe analiza të ngadalta dhe jo partizane. Për Tahirin nuk mendoj asgjë.

**Duke lu pyetur për ministrin e sapo-dorëhequr, thua se vendi është në krizë, është një rrotacion, i cili duhet të ndodhë?**

Unë jam munduar të bëj një deklaratë timen. Unë e dua vetën të shkëputur nga maskarada politike. Kur ti e sheh të natyrshme të kundërshtosh qeverinë, ti etiketohesh si kundërshtar. U desh 30 vjet, që u vërtetua se nuk u bëra pjesë e nëndeshme dhe pjesë e konspiracioneve. Mua më kujtohet, që në këtë shtafje, unë kam bërë një deklaratë, e cila nuk u përmend kurë. Do të jem kundër çdo qeverie, sepse unë jam i lirë dhe liria ime ka shumë rëndësi. Për mua rrotacioni sjell ndryshim. Nuk i heq asnjë presje këtij qëndrimi. Duke qenë qeveria autoritet, kollaj bëhet autoritative. Kjo Shqipëri është e njerëzve të zakonshëm. Jam ca nga ne, të cilët duhet të mbrojnë interesin e publikut. Unë shoh disa kolegë të mi, të cilët luajnë rolin e propagandës qeveritare, por s'janë aspak të lumtur.

**Pse janë të palumtur?**

Nuk e di, një pjesë bëjnë gazetari të vërtetë. Disa i shoh që përpigjen të mbrojnë të pambrojtshmen.

**Nëse ju pyes, çfarë më thonë për Ramën?**

Më duket fare normale, që

Rama të komentojë thënieën e gazetarëve të rëndësishëm në vend. Që të jem i ndershëm me ty. Seriozisht nuk kam asnjë koment, nuk mendoj se ia vlen të kem pyetje për këtë.

**Ku ndryshon pushteti Rama nga pushteti Berisha?**

Kjo është një pyetje, e cila më duhet të bëjë një analizë deontologjike. Tani nuk dua të bëj analizë. Ka ngjashmëri, ka dallime. Ka shumë njerëz, të cilëve iu ka ardhur në majë të hundës. Elementi të cilët nuk kanë ndryshuar, siç janë lufta politike, stigmatizimi, gjuha e përdorur. Kam një përshtypje. E shoh se në shoqërinë tonë njerëzit apo votuesit reagojnë më ngadalë. Vendet që janë më të zhvilluara reagojnë më me shpejtësi. Pra, nuk pres pa fund se lodhuri, që pas disa kohësh të them tani ka ardhur koha për t'i dhënë votën atyre të tjerëve. Rrotacioni është i mirë.

**A kemi një opozitë të fortë, Basha si po e bën opozitën?**

Të gjitha pyetjet që ke bërë, unë kam qenë i kujdesshëm të mos bëj një përcaktim politik. Kur ne dhe zërat e rëndësishëm gjatë periudhës së PD në pushtet thoshim se si qeverisja autokratike, rregulli në sjellje, agresiviteti dhe mbajtja me dorë të hekurit, do të sjellë asgjësimin e PD, por kjo atëherë sillte të qeshura.

**Çfarë këshillash ke marrë nga bashkëshortja juaj?**

Ajo nuk ndihet mirë që kur i ka dalë emri në publik. Ne jemi në një profesion. Por ne mundohemi të lexojmë në fusha të ndryshme. Nuk është se marr sugjerime vetëm nga bashkëshortja, por që në fillime më ka qëlluar të punoj

me figurat më të rëndësishme.

**Me familjen sa i lidhur është Adi?**

Kjo është një pyetje retorike. Komunikimi i ndjeshëm, ata janë në një fazë, të cilët kanë formuar karakterin e tyre. Me thënë të drejtën gruan nuk do ta kem në emision, por as edhe fëmijët. Them se do të kemi të ftuar personazhe me interes për publikun, të cilët do të shoqërohen me sqimën përkatëse. Nuk dua të bëhem kryeministër. Unë dua të komunikoj me publikun. Unë këtë herë në këtë program do të kërkoj hapur që të kemi një dialog transparent. Për mua do të jetë kështu dhe kështu do ta bëjmë. Ne kemi menduar të bëjmë një program, i cili nuk kërkon të tregojë muskujt, por komunikimin e publikut me shqetësimet që ka.

**Lider të fortë dhe institucione të forta a ka?**

Pyetja është retorike. Përgjigjen e ka brenda. Përgjigja është; po. (Qesh)

Flasim për ligjin antishpifje Personi që është i dëmtuar bën një padi dhe ajo zgjidhet. Nuk ka nevojë që të bësh një zhurmë të madhe për të treguar se çfarë po bëj unë. S'jam dakord për këtë zhurmë për shpifjen. Ngjarja është e parëndësishme. Është thellësisht e shoqërueshme për drama të tjera. Ka shumë probleme të tjera Shqipëria që të merresh që të harxhosh kohë.

**Kryeministri ka hapur edhe fondin për këtë ligj...**

Kjo është futja kot. I dhe shumë minuta kësaj ngjarje.

**Po vet kryeministri Rama a shpif?**

Të të them të vërtetën? S'marr

mundim që t'i përgjigjem kësaj pyetje.

**A luftohet me liri shprehjesh shpifja?**

Ne sot flasim për 'Fake news'. Ai nuk erdhi në përballjen e madhe Clinton-Trump. Ka qenë një problem i vazhdueshëm. sot nuk tingëlloi më njeri i show. Kolegët e mi bëjnë show dhe nuk është i bukur. Marrëdhënia me mediat është komplekse. Pse do të duhet të arrinin në mendime përgjithësuase?!

**Të bëjnë përshtypje disa tema; 'kazan'! Ndërkohë Meta tha dje 'delinkuent'...**

Ky është një vend mesdhetar ku njerëzit kanë gjuhë me ngjyrimë të ethshme dhe me nuanca. I takon kulturës së gjithësecilit, kë kanë pasur gjysh, baba, apo dhe nëna, apo dhe mësuesit. E kam shumë të lehtë të të bëj show-n e një klouni. E kam shumë të kollajshme, por s'më lejohet ta bëj. Unë duhet të jem i kujdesshëm. Çdo rast tjetër që na vjen përballë, s'do duhet të na gjejë të papërgatitur. Nuk është kjo normalja. Jemi në një kohë në Shqipëri që anormalja është kthyer normale. Jemi në një vend me politikë anormale, me zgjedhje anormale.

**Berisha prodhon politikë sa një parti më vete. Si e shihni komunikimin e tij?**

Më kujtohet njëherë që e kam takuar rastësisht. Pasi kam mbajtur qëndrime kritike ndaj PD. Siç kam mbajtur dhe mbaj gjithmonë. I kam thënë: 'Zoti Berisha s'kam qenë dakord me politikën tuaj'. Kurse ai më tha: 'Zoti Krasta ju ka pas hije qëndrimi juaj'. Ka një dallim të madh me të, ai është një dashurues i leximit, është një njeri i kulturuar. S'më lejon që të bëjë komente për të. Se gjej pyetjen të përgjegjshme.

**Adi Krasta është në 'News24'. Përveç emrit televiziv Krasta, çfarë sjell ky program?**

Konkurrimi ka kaluar në televizionet e niveleve të informacionit, siç është edhe News24. Që të jem i ndershëm me ty, në një bisedë që kemi bërë me Hysenbelliun për të filluar punë më tha: "Eja në News24 që të flasësh për çfarë të duash dhe kur të duash. S'do kesh kurrë një shqetësim". Për mua është fondamentale të flas pa filtra. Nuk mendoj se jam aq i rëndësishëm. Shqipëria, po tregon se duhet të bësh shumë që të reagonin në ndonjë formë. Nëse ka ndonjë lëkurë hollë, që tendosen nga një shaka televizive, tregon se është problem i tyre. Dua që të pranosh një kërkesë timen që në emision të jeni aty të analizojmë çfarë ka ndodhur gjatë javës. Në emision s'ka gjë spektakolare, por ajo që ndodh. E kam menduar që këtij publiku në këtë kaos, që janë njësoj, t'i propozojmë diçka tjetër. Që do të jetë në prime time çdo ditë hënë. Do ketë informacion, biseda, pyetje. Asgjë si pikë kthesë në historinë televizive. Unë jam antikonformist që në lindje.

Opinion i Ditës

# Angela Merkeli hapi rrugën për epokën pas saj

Nga Deutsche Welle

(vijon nga faqja 1)

## ARGUMENTET PËR TËRHEQJEN

... të mos kandiduar më në dhjetor si kryetare e kristjan-demokratëve gjermanë. Ajo u dha të drejtë të pakënaqurve me figurën që bënte qeveria federale: e quajti të papranueshme pamjen që përcjell qeveria në popull. Kjo në një kohë kur rezultatet e punës nuk mungojnë.

Kam ndjesinë se është koha për të hapur një kapitull të ri, u tha ajo të pranishmëve në konferencën e shtypit, të parën të mbajtur pas zgjedhjeve në Hessen. Politika nuk mund të vazhdojë njësoj, pas rezultateve të dobëta të partive qeveritare në Bavari dhe Hessen. Prandaj Merkeli hap rrugën. Ajo thotë shprehimisht se CDU-ja mund të përgatitet në dhjetor për kohën pas saj, me drejtues të rinj dhe program të ri.

Kancelare ajo dëshiron të qëndrojë deri në fund të mandatit, në vitin 2021. Por thotë se nuk e ka "harrur që nuk ka lindur kancelare". Një veprim pa precedent ky hap i Angela Merkelit, edhe në historinë e Gjermanisë. Ajo thotë se është e ndërjegjshme për këtë, por ai sjell më shumë shanse se rrezje.

CDU-ja do të hapë një fletë të re: 18 vjet pasi politikania me origjinë nga lindja e Gjermanisë mori drejtimin e partisë së Helmut Kohlit, që i kishte drejtuar konservatorët 25 vjet me radhë.

## PO KANCELARE, A DO TË QËNDROJË MERKELI?

Në konferencën e shtypit Angela Merkeli tha se ndarja e postit të kryetarit të partisë nga ai i kancelarit është e mundur, edhe për CDU-në. Sepse është e përkohshme. Ajo nuk do të rikandidojë më si kancelare, as si deputete pas këtij mandati. Merkeli ndërpret me ndërjegje një traditë të CDU-së, ku postet e kancelarit dhe të kryetarit të partisë i ka ushtruar një person. Por me këtë, ajo nuk i lë ngjarjet ta vënë përpara.

Erozioni i besimit për CDU-në në popull u kishte dhënë më parë forcë kritikëve të politikës së saj: Volker Kauder, i besuar i Kancelares dhe prej 13 vjetësh në krye të Grupit Parlamentar CDU/CSU, papritur nuk u rizgjedh në post. Spekulumet se kjo mund t'i ndodhte edhe Merkelit në kongresin e partisë mbeten spekulime, aq më tepër kur të CDU-ja postë i kryetarit është i lidhur me atë të kancelarit.

Për sa i përket pozicionit në sistemin politik, një kancelar në Gjermani ka pozitë të fortë. Kush-tetuta gjermane përcakton që kancelarin nuk mund ta largojnë dot kundërshtarët, nëse parlamenti nuk mbledh dot një shumicë për një kancelare të re. Dhe kjo duket e pamundur për momentin. Presi-



denti i Bundestagut, Wolfgang Schäuble, i tha DW se CDU-ja është e vendosur të mos e lërë tani kancelaren të duket e dobët, lame duck, si i thonë amerikanët.

## KANDIDATËT PËR POSTIN E KRYETARIT TË CDU-SË

Për Gjermaninë ka nisur periudha, kur shikohet për kohën pas kancelares, siç e dëshiron edhe ajo. Në këtë kuadër, me shpejtësi pas deklaratës së Merkelit, paraqitën kandidatët për kryetarë partie tre kandidatë: Annegret Kramp Karrenbauer, sekretare e përgjithshme e CDU-së, e preferuara e Kancelares. Ministri i shëndetësisë, Jens Spahn, i njohur më parë si kritik i Kancelares. Ai është përplasur me të për temën e migrantëve dhe ka kundërshtuar më parë nënshtetësinë e dyfishtë. Dhe Friedrich Merz, ish-kryetar i grupit parlamentar të CDU/CSU - por prej dhjetë vjetësh sipërmarrës ekonomik. Ai u largua pasi kundërshtoi zhvendosjen e CDU-së drejt qendrës, nga Merkeli.

## FAKTORËT ME NDIKIM PËR KANCELAREN

Në tri vitet e ardhshme mund të dalin shumë faktorë. Më të afërmit në kohë: Në 2019-ën, veç zgjedhjeve evropiane, janë zgjedhjet rajonale. Në katër landet e Gjermanisë: në Bremen, në Brandenburg, në Saksoni dhe në Tiringi. Në këto lande lindore, vjet hyri në parlamente partia populiste AfD, me refuzimin e qartë të migrantëve. Po u forca me AfD-ja, përgjegjësia do të kërkohet sërisht në qeverinë federale.

Faktor tjetër janë social-demokratët në qeveri. Ata nuk duan të dalin nga qeveria, sepse SPD ka rënë shumë në elektorat. Dhe do ta shfrytëzonin shansin rivalët. Të Gjellbrit gjithsesi po forcohen, edhe në kurriz të SPD. Por po u detyruan social-demokratët të dalin nga qeveria, nga presioni i bazës, priten zgjedhje të reja. Dhe Merkeli dek-

laroi se në një rast të tillë nuk kandidon më.

Një faktor i tretë është edhe se kush do të zgjidhet kryetar i CDU-së në dhjetor. Me zonzjen Kramp-Karrenbauer kancelarja kuptohet shumë mirë. Në postin që ka atë e solli vetë Merkeli, pas suksesit të bujshëm të AKK (siç i thonë në parti) si kryeministre e Landit të Zaresë.

Më pak do të kuptohej me ministrin e Shëndetësisë, Jens Spahn. Spahn konsiderohet talent politik. Pas hyrjes në qeveri, nuk u dëgjuan më kritika publike të tij ndaj Merkelit. Vëzhgues të ndryshëm thonë megjithatë se atij i duhet ende kohë për të fituar aftësi për postin e kryetarit të CDU-së.

I vështirë shihet një bashkëpunim me Friedrich Merz-in. Pas largimit nga drejtimi i grupit parlamentar, Merz-i bëri karrierë të suksesshme në ekonomi, në bordin e koncerneve të mëdha. Pozicioni i tij ideologjik do ta kthente CDU-në në fillimet e saj: më pranë krahut liberal dhe konservator ekonomik. Vëzhguesit thonë se synimi i tij është posti i kancelarit. Por ai do të ishte i papranueshëm për SPD-në dhe do të përlajmonte zgjedhje të reja.

## KLIMA POLITIKE DHE NDAJ KANCELARES

Ka vazhduar rënia e mbështetjes për partië të mesit, të qendrës. Nga 53,4 përqind që kishin ato në zgjedhjet vjet, tani diskutohet nëse CDU/CSU dhe SPD e kanë apo jo shumicën për qeverisje. Por ekstremizmi, mbështetja për partië të majtë dhe të djathtë është të 20 përqindshi. Ende nën kontroll.

Tërheqja e pjesshme e Merkelit pritet të ketë edhe psikologjikisht efekt pozitiv. Tek ata që e bëjnë kancelaren përgjegjëse për çdo pakënaqësi në jetën e tyre. Në radhë të parë të ata që bezzisen nga migrantët, për praninë e të cilëve në Gjermani akuzojnë

hapjen e dyerve nga Kancelarja. Dhe që ndiheshin të provokuar edhe vetëm nga shprehja e Merkelit "Do t'ia dalim mbanë".

Në radhët e politikës gjermane, në pjesën dërrmuese tërheqja e ardhshme e Kancelares nga posti i kryetares së partisë u vlerësua si hap dinjitoz. U shpreh më tej keqardhje, edhe nga njerëz të medie. Së shpejti, me tërheqjen e Merkelit mund të marrë fund edhe mënyra si i trajton ajo gazetarët: me modesti, me respekt dhe e përqendruar në fakte. Vlera të rralla sot, kujtoi një gazetar.

## EUROPA DHE BALLKANIN PAS VENDIMIT TË MERKELIT

Gjermania hyn tani në një periudhë tranzicioni politik. Mundësitë janë që për sa i përket Evropës, roli stabilizues dhe vendimtar i Gjermanisë të vazhdojë njësoj. Kjo ka rëndësi, pasi pa miratimin e Gjermanisë ose angazhimin e plotë të saj në procese, pak gjëra lëvizin në Europë. Merkeli do të qëndrojë në postin ekzekutiv, vendimmarrës të kancelares.

Por tërheqja nga drejtimi i CDU-së i shtyn analistët të nisnin që tani bilancet. Të kujtojnë p.sh. sa i fortë dhe stabilizues ka qenë ndikimi i Angela Merkelit për Evropën: në krizën financiare; në kohën e dobësisë së Francës, kur Britania e Madhe kishte (dhe ka) probleme, kur situata në Itali është e paqartë etj.

Angela Merkeli e ka mbështetur personalisht zgjerimin e Bashkimit Evropian me anëtarë të rinj, në këtë kuadër dhe me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Me iniciativën e saj nisi Procesi i Berlinit, dhe pas tij Berlin Plus, seria e programeve dhe iniciativave për investime ekonomike, që afrojnë Ballkanin me BE. E paqartë nëse dikush tjetër do të tregojë të njëjtin përkushtim personal. Gjithsesi, Europa funksionon edhe në bazë të proceseve të nisura. Gjermania do të jetë njësoj pjesë e tyre.

### HOROSKOPI

**DASHI**  
Sot do të arrini në një konkuzion në lidhje me çështjet familjare apo me mënyrën se si do të arrini të bëni edhe një lëvizje të fortë në çështje të karrierës.

**DEMI**  
Një ditë paksa me tensione midis jush dhe personave që janë pjesë e shoqërisë suaj, pasi nuk do të gjeni mirëkuptim për gjërat që doni të bëni. Në të tilla situata duhet të tregoheni tolerantë.

**BINJAKET**  
Sot do të jeni të papërbajtur në lidhje me mënyrën se si do veproni apo do t'i thoni gjërat. Ka mundësi të mos jeni aspak diplomatë dhe kjo do t'ju krijojë disi më shumë probleme.

**GAFORJA**  
Ditën e sotme do ndjeni se ndryshimet që bëhen rreth jush nuk janë aspak të këndshme, por të detyruara nga persona që ju i mendoni si kundërshtarë apo nga presioni që mund t'ju bëhet për të bërë ndryshime.

**LUANI**  
Ditë e mirë për të dashuruarit. Do jeni më të lidhur se kurrë me partnerin. Sa u përket parave, të gjitha mundësitë janë të mira, por duhet të dini si t'i kapni këto mundësi.

**VIËRJETESHJA**  
Dita e sotme në përgjithësi do jetë shumë e fortë në lidhje me anën ekonomike. Në fakt, duke parë se do ju duhen më shumë para, atëherë do detyroheni të gjeni edhe mënyra të tjera për t'i fituar.

**PESHORJA**  
Ditën e sotme ka disa çështje që ju nuk i keni zgjidhur apo logjikuar siç duhet si në lidhje me qëllimet tuaja, ashtu edhe në lidhje me jetën tuaj personale. Sa u përket parave, bëni kujdes me shpenzimet!

**AKREPI**  
Dita e sotme në planin e karrierës dhe të familjes do mbart tension apo acarim. Ka mundësi që t'ju duhet të jeni më afër familjes. Në planin financiar, jo gjithçka është në rrugën e duhur.


**SHIGJETARI**  
Sot do të keni shumë shpenzime, të cilat me sa duket nuk i prisnit dhe do t'ju duhet të filloni të bëni plane për të fituar më shumë. Do të keni ide të reja dhe kjo do t'ju ngrejë moralin.

**BRICJAPI**  
Po mendoni që të bëni disa ndryshime në jetën sentimentale. Kujdesuni që gjithçka të bëhet me kujdes në çdo detaj. Dikush mund të përpiqet të përfitojë në kurrizin tuaj.

**UJORI**  
Ditën e sotme një konflikt apo një incident i vogël mund t'ju sjellë pasoja. Përpiquni të shmangni përplasjet me një koleg, i cili ka më shumë mbështetje sesa ju.

**PESHQIT**  
Prezenca e Hënës sot në shenjë tuaj ndoshta do t'ju bëjë që të jeni më të ndjeshëm ndaj kërkesave të të tjerëve. Kjo do të bëjë që disa zakone në jetën tuaj të ndryshojnë.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Dillon aktor.
5. Një listë që zgjidhet nga regjisori
9. Sigla e tritolit.
12. Kapitani që ndiqte balenën Moby Dick.
14. Eshhtë spektator i yni.
16. Fillojnë lejen
17. Një sinjal akustik.
19. Një parashitesë për... përtej.
20. Eshhtë partia e Sali Berishës.
23. Kanë organizatën Hamas.
24. Gëlojnë nga murgjit.
25. Në teori kur mungon ti.
27. Inicialet e Gide.
28. Inicialet e Asimov.
29. Nisen pa ne.
31. Kreshniku i voleybollit.
36. Kufijtë e tokës.
37. Mund të jenë autonome të tilla.
38. Britma e Arkimedit.

41. Fillojnë vetëm.
42. Bota jashtë ëndërrës.
44. Mund të jenë ushtarake.
46. Italia në Internet.
47. Gjysmë atomik.
49. Janë prova inteligjence
50. Një libër hartash.
51. Clapton i muzikës.

**VERTIKAL**

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një... bombë tenistike.
3. Fillojnë themelet.
4. Mund të jetë klasifikimi.
6. Një letër... kampioni.
7. Eshhtë pozicioni për gjumë.
8. Janë diktatorët despotikë.
9. Një kryeqytet afrikan.
10. Që mesfushor i famshëm i Ajax.
11. Ekstremitë në tenis.
13. Eshhtë e dendur në xhungël.
15. Eshhtë brinjë në skuadër.
18. Eshhtë pako që dërgohet.
20. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
21. Bëjnë taktika me taka.
22. Vetot pa kufij.
23. Persekutoniin romakët.
24. Eshhtë gri ajo e trurit.
26. Një mund të jetë spiuinzi.
30. Janë vendet për niseje.
32. Me to bëjnë torta.
33. Janë katër në kitarë bas.
34. Institucione Urbane Rajonale.
35. Priten me lotë në sy.
39. Një rreth pa ekstreme.
40. Gjysmë kasate.
41. Eshhtë cilësia.
43. Ente Tregtare Lokale.
45. Një pjesë e territorit.
48. Një hyrje të oazit.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Jagger i Rolling Stones.
4. Zanore për kuaj.
6. Janë dhelptra.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Kufizojnë rastet.
14. Mbyllen me epilog.
16. Eshhtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
18. Gjysmë njeriu.
20. Janë fruta ekzotikë.
21. Një minierë e vjetër.
23. Ata tanë ishin ilirë.
24. Masat pa kufij.
25. Një gëzim i madh.
26. Agjenci Ndërmjetese Përmet
27. Eshhtë godinë në miniaturë
29. Film i Ridley Scott
31. Duken të gjata në pritje.
32. Njëzetmijë... në det në një libër të Jules Verne.

**VERTIKAL**


34. Eshhtë kreu i bandës.
36. Ndahen nga ortakët.
38. Eshhtë numri një.
41. Janë trupa qiellore të tillë.
44. Kanë dhoma për t'u zënë.
46. Tri çupa në poker.
47. As unë, as ai.
48. Janë vitet.
49. Pak amatoriale.
9. Eshhtë e parë për prodhim.
10. Kush ka do të pijë.
13. Janë binarë.
15. Rolet pa ret.
16. Vihen për të mbyllur të tilla.
17. Janë tek në mantel.
19. Salgari që krijoi Sandokan.
20. Një stinë e ngrohtë.
22. Janë pamje nga puna.
26. Një fjalë goxha.
27. Ato Eilliams janë teniste
28. Ishin të parët tanë.
29. Janë edhe ato polare.
30. Fillojnë nazet.
33. Inicialet e Triolet.
36. Një bëhet me pozë.
37. Mbyllin punimet.
39. Nodoh në kufij.
40. Perignon i champagne-s.
42. Eshhtë iks ajo e sulmit.
43. Emti europian i hapësirës.
45. Fillojnë lehtë.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

H	E	S	A	P	E	T	T	P	A	B	C
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E
L	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T
E	L	S	A	D	R	T	V	A	L	E	T
N	E	R	R	I	M	E	T	A	T	A	
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T
F	E	L	L	A	N	I	E	M	E	A	
P	L	A	A	T	O	M	I	K	E		
A	N	S	T	E	R	E	O	O	L	I	T
P	A	R	S	I	D	M	A	R	I	A	
A	N	A	N	I	A	P	R	E	S	I	O
S	A	R	D	O	U	D	E	T	I	T	A
P	A	R	A	G	R	A	F	I	V	A	
I	R	O	N	I	A	O	S	I	E	R	A
R	A	B	A	T	B	A	N	A	R	A	
A	M	E	T	A	N	V	R	I	T	M	A
T	T	R	T	E	L	E	M	A	K	U	L
S	A	S	P	O	L	E	M	A	K	U	L
V	K	A	N	A	R	M	I	N	A	E	N
A	L	V	A	T	I	K	A	N	I	E	N
J	O	E	T	I	N	E	T	E	M	A	
A	R	I	M	A	R	A	D	E	T	I	A
A	R	I	A	N	A	R	U	N	I	K	E
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	I	C

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

**SUDOK**

	5	8						9
			7	5				2
		3	1	9				4
						9	4	
9			3				1	6
		6	8					
	6				8	5	1	
		7		9	5			
	9					7	6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	2	9	1	8	3	5	6	4
5	4	1	2	9	6	3	7	8
8	3	6	4	5	7	2	9	1
9	1	4	3	2	5	7	8	6
3	5	8	6	7	4	1	2	9
6	7	2	8	1	9	4	3	5
1	9	7	5	3	8	6	4	2
2	6	3	9	4	1	8	5	7
4	8	5	7	6	2	9	1	3

*Argëtim filozofik*

- Njerëzit e mençur mësojnë nga gabimet e huaja, budallenjtë nga të vetat
- Koha është pasuria e vetme, për të cilën mund të tregohemi koprracë pa u turpëruar
- Njeriu i uritur, nuk është njeri i lirë
- Njeriu të mos ketë frikë nga ligji, të ketë turp nga bota, të ketë frikë nga ndërgjegjeja e tij
- Kush nuk merret vesh me vëllanë, s'merret vesh fare me bashkëqytetarët e tij
- Të gabosh dhe kërkosh fajje është njerëzore, të falesh është hyjnore e të mos heqësh dorë nga gabimi është

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

13	4	15	8	0	14	4	14	7	4	15		
4	11	4		1	8	12	2	3	14	5	10	
10		1		4	1	2	8	10	6	4	7	5
4	7		1	7	5	8	9	4	2	10	4	
15	3	1		6	2	10	5	2	6			12
7	1	11	13	5		1	5		17	15	1	
17	3	10	13	3		4	4		4	10	6	3
4		2	4	7		11		6	10	4	2	4
12	1	5	16	4	10	5		4	4	8	16	
14	4	7	4		8	14	5		17	3	10	10
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5	4
2	4	2	5		4	1	2	8	10	6		2

C	R	A	L	K	I	M	I	S	T	I	
C	O	S	T	N	E	R	P	A	V		
I	L	R	M	I	I	K	L	A			
R	K	O	P	E	R	N	I	K	U	N	
K	O	O	P	E	R	A	T	I	V	A	T
K	L	I	N	I	K	E	L	F			
T	R	O	K	E	I	R	O	N	I	K	E
R	S	A	L	T	E	V	I	T	A		
I	T	A	L	I	A	S	E	E	V	A	
U	L	E	M	A	R	T	A	C			
M	A	E	J	E	A	N	L	I	J	A	
F	U	T	U	R	I	S	T	E	T	A	R

*Chënie të mençura*

- djallëzoreforca, por ai që bazohet në drejtësinë, është i mbështetur në një godinë të fortë që nuk shembet kurrë
- Fjalët dhe punët e njerëzve të mëdhenj nuk janë sipas vendit e kohës së tyre, ata mund t'i përshatën çdo kohë dhe çdo vendi
- Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë
- Ai që i përgjigjet me ligësi mirësisë sate, bëhet mjet për të bërë të njohur mirësinë tënde dhe ligësinë e vet

